



D R I T A

"Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon".

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Qershor 2007 • Viti XXIV • Nr. 2 (153) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA 2.5\$



BEKIMI I KISHËS "ZEMRA E KRISHTIT" NË VITI. Më 15 qershor 2007 në Viti u bë bekimi i Kishës së re kushtuar Zemrës së Krishtit dhe qendrës pastorale "Nënë Tereza". **FAQE 2**

KREZMIMI NË FAMULLITË TONA. Pas përgatitjes përkatëse për vite me radhë në mësim besimi, shumë të rinj e të reja nëpër famullitë tona morën sakramentin e krezmimit, i cili është një nga tri sakramentet e iniciacionit të krishterë. **FAQE 3**

REPORTAZH
Lurdi - vend i lajmërimit të Zojës Mari.
(SHKRUAN: DON MARJAN MARKU)
FAQE 10-11



KËNDVËSHTRIM

SFIDA JONË SOT

Hyji, Ati i të gjithë popujve, nëpërmjet Moisiut e ngriti Popullin e Zgjedhur. Atij ia krijoi mundësinë të jetë Bashkësi njerëzore, e largoi nga prangat e Robërisë për ta shpënë në Liri; ia dha Urdhërimet si rregullore e jetës, një lloj kushtetute bazë e marrëdhënieve ndërnjerëzore, dhe, në raport me Hyjin, që Bashkësia ta ketë harmonizimin dhe miqësinë e Hyjit dhe njeriut.

Që atëherë e deri më sot, të gjithë popujt e aspirojnë këtë Liri, e cila në mënyrë të vazhdueshme krijon mënyra të ndryshme për të arritur aspiratat e veta si e drejtë natyrore. „Magjisteri i Kishës mëson se e drejta ndërkombëtare mbështetet në parimin e respektimit të barabartë të shteteve, të së drejtës për vetëpërcaktim të secilit popull dhe të bashkëpunimit të lirë për një të mirë më të madhe të përbashkët të njerëzimit". Pajja bazohet jo vetëm në respektimin e të drejtave të njeriut, por edhe në atë të të drejtave të popujve, në veçanti të së drejtës për pavarësi." (Papa Gjon Pali II).

Përpjekjet tona të kamotshme, për ta bërë të qenë të drejtën e mohuar të të qenit të pavarur, ishin të shpeshta dhe kanë kërkuar shumë sakrifica individuale dhe kolektive.

Tani kur gjendemi në fazën përfundimtare të përpjekjeve tona shekullore, mjerisht, fazë kjo e tejzgjat, na bën herë entuziast se ia dolëm, herë na shkurajon se na iku. Ky realitet i ankthshëm mes "tani, por bala jo", kërkon zgjuars, këmbëngulje e durës. Prandaj duhet gjetur energji të reja për të ruajtur paqen.

Kisha e ka fuqinë e vet në lutje dhe në dashuri, prandaj nuk do të pushojë as tani, të përkëdhelë me dashuri popullin e vet dhe të lutet për ndriçimin e mendjeve dhe të zemrave të faktorëve vendimarrës, që të jenë besnikë ndaj premtimeve të dhëna. Dihet që moti, se insistimi i kundërshtuesve të sotëm dhe kompromiset e bëra më parë, asnjëherë nuk kanë kontribuar (në mënyrë afatgjate) në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes.

Qëllimi do të arrihet, sot apo më vonë, prandaj të gjithë duhet të jemi të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm, se arritjet s'janë pronë e askujt, por investim i energjive dhe kapaciteteve tona të përbashkëta, të cilat ditëm e duhet ditur t'i drejtojmë kah e mira e të gjithëve. Kështu që askush s'duhet të ngutet të përvetësojë meritën dhe në emër të saj të tentojë t'i anashkalojë të tjerët.

Si do që të jetë, ne po ia arrijmë të na njohin pavarësinë politike dhe gjeografike, por lypset që pavarësinë tonë shpirtërore ta njohim vetë. Kjo arrihet me përpjekjen e secilit për të zbuluar të mirën në vetvete dhe rreth vetes. Sa më shumë bëjmë mirë aq më shumë jemi të lirë, sepse liria e vërtetë është e dobishme vetëm nëse ajo është në shërbim të së mirës.

Imzot Dodë GJERGJI

Bazilika paleokristiane e Studenicës dhe ndërhyrjet e Kishës Ortodokse Serbe

FAQE 8-9

Shkruan:
Prof. Dr. Jahja DRANÇOLLI

Intervistë me Imzot Zef Simoni, ipeshkëv ndihmës i Shkodrës

Shqipëria nuk është shtet mysliman

FAQE 12-13



Presidenti Bush në audiencë te Papa Benedikti XVI

Më 9 qershor 2007 Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, George W. Bush, u prit në audiencë nga Shenjtëria e Tij, Benedikti XVI. Gjatë bisedimeve të përzemërta, u shqyrtuan temat kryesore të politikës ndërkombëtare, duke u ndalur posaçërisht, për sa i takon Lindjes së Mesme, tek çështja izraelito-palestineze, tek situata në Liban, situata shqetësuese në Irak dhe tek kushtet kritike në të cilat ndodhen bashkësitë e krishtera. Selia e Shenjtë uroi edhe një herë që

konflikti dhe kriza që trondisin Lindjen e Mesme të gjejnë një rrugëzgjdhje "zonale", "fryt i bisedimeve". Gjatë audiencës, vëmendje e posaçme iu kushtua edhe Afrikës e zhvillimit të saj, duke theksuar sidomos situatën në Darfur; por nuk mungoi edhe shkëmbimi i opinionëve për situatën në Amerikën Latine. Së fundi u shqyrtuan çështjet e sotme morale e fetare, ndërmjet të cilave, problemet që lidhen me të drejtat e njeriut e me lirinë fetare, me mbrojtjen e promovimin e jetës, martesën e familjen, edukimin e breznive të reja e zhvillimin e qëndrueshëm".

Duke u kthyer në kronikën e këtij takimi të rëndësishëm, kujtojmë se korteu presidencial arriti në Oborrin e Shën Damascit rreth orës 11:03. Për ta pritur Presidentin Bush dhe bashkëshorten e tij Laura kishte dalë prefekti i Shtëpisë Papnore, imzot Xhejms Majkëll Harvej, i cili i shoqëroi Presidentin dhe Zojën e parë amerikane, veshur me të zeza, me kokën

mbuluar me vel, sipas rregullave protokollare. Takimi u zhvillua në Sallën e Bibliotekës së Palatit Apostolik, ku Papa bisedoi gjatë, privatisht, me Zotin Bush. - Takimi i G 8 ishte një sukses - pohoi Presidenti, duke iu përgjigjur pyetjes që i bëri Papa i cili, sapo e takoi, e pyeti pikërisht për rezultatet e samitit të Gjermanisë, ku u takuan fuqitë e mëdha. Në fillim të bisedimeve me porta të mbyllura, që zgjatën një gjysëm ore, Benedikti XVI u interesua posaçërisht për ndihmat në favor të Afrikës, temë në rëndësi e breznive të reja e zhvillimin e qëndrueshëm".

Në përfundim të bisedimeve, sipas traditës, u shkëmbyen dhuratat. Benedikti XVI i dhuroi Presidentit Bush një stampë të Bazilikës së Shën Pjetrit, realizuar në vitet '700, ndërsa Presidenti i dhuroi Papës një bastun të bardhë, në të cilin ishin skalituar me ngjyra të ndryshme, 10 Urdhërimet e Tenzot.

FAQE 4



Bekimi i Kishës “Zemra e Krishtit” në Viti



Mesha solemne me rastin e bekimit të Kishës në Viti

Më 15 qershor 2007 në Viti u bë bekimi i Kishës së re kushtuar Zemrës së Krishtit dhe qendrës pastorale “Nënë Tereza”, e cila është e bashkangjitur në kompleksin e Kishës dhe do të jetë në shërbim të të gjithë të rinjve të komunës së Vitisë.

Mëshën, në koncelebrim me

shumë meshtarë, e udhëhoqi ipeshkvi ynë, Imzot Dodë Gjergji. Të pranishëm ishin shumë besimtarë nga të gjithë famullitë e Kosovës e në veçanti besimtarët e famullive përreth, të cilët e kanë ndihmuar ndërtimin e gjithë këtij kompleksi më se të nevojshëm për Vitinë. Në mesin e shumë pjesë-

marrëse duhet të veçohen autoritetet komunale: kryetari i komunës së Vitisë, z. Musa Misini, ish kryetari i komunës së Vitisë z. Samet Dalipi, tani këshilltar i Kryetarit të Kosovës Dr. Fatmir Sejdiu, përfaqësuesit e SHPK të rajonit të Vitisë dhe asociacionet tjera të shoqërisë civile.

i ndjeri Imzot Mark Sopi më 23 nëntor 2003.

Projektin ideor e ka punuar inxhinieri i njohur italian, Nicola Danza, së bashku me arkitektin Roberto Mancano nga Bari. Projektin për ndërtim dhe mbikëqyrjen e të gjitha punimeve të brendshme dhe të jashtme, e kanë bërë dy vëllezër tanë: Ismail Baftijari dhe Bardhok Jetishi. Punimet i ka kryer ndërmarrja ndërtimore e Stubllës “Kristal” në krye me Franklin Ramajn. Punimet e deritanishme kanë kushtuar afro 1 milion euro.

Me ndihmën e Zotit, të besimtarëve tanë nga Stublla, Binça, Kabashi, Vitia, si dhe të punëtorëve tanë në botën e jashtme, të shumë bamirësve të njohur dhe të panjohur, kemi ardhur deri këtu.

Dhe ja, sot, më 15 qershor 2007, në Festën e Zemrës së Krishtit, Shkëlqesi e dashur dhe e nderuar, Imzot Dodë Gjergji, do ta bëni bekimin dhe përrimin i Kishës dhe Shenjtërores “Zemra e Krishtit” dhe i Qendrës Pastorale “Nëna Tereze”, gëzimi i parë i tillë për Ju si Bari kësaj Kishës, në dhjetëvjetorin e “kthimit në Shtëpinë e Atit” apo të “kalimit në amshim” të Nënës sonë të madhe.

Le të jetë kjo ditë dhe ky bekim ogurmirë për Kishën dhe

Kosovën tonë, për Shenjtëroren dhe Katedralen e Nënës Terezë në Prishtinë, për ndërtimin e Kosovës vërtet të lirë dhe të mirë, demokratike, shembull të paqes, pajtimit, bashkëjetesës, dialogut ndëretnik, ekumenik dhe ndërfetar, të vlerave tona të lashta dhe të tashme ilire-shqiptare dhe të krishtera, të kulturës së jetës dhe qytetërimit të dashurisë.

Thënë me gojën dhe zemrën e së lumes Nënës Terezë, e cila para trupores së Zemrës së Krishtit në Shkup, dhe të Zonjës Černagore në Letnicë, vendosi të bëhej Misionarja dhe Nëna e botës, duke dëshmuar bindshëm në mbarë njerëzimin fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë, edhe ne sot përkujtojmë dhe pohojmë së bashku me Të :

“Pa dashuri dhe fljimm jeta s’ka kuptim” dhe “Vetëm dashuria do ta shpëtojë botën”.

Fljijme patëm mjaft, bile edhe për së tepërmi, dhashtë Zoti dhe ndërmjetësia e Nënës Terezë që të kemi gjithnjë e më tepër afërsi dhe bashkëpunim me Zotin-Dashuri dhe Vëllanë-Njeri.

T’i kthem vetvetes dhe të Vërtetës! Kjo Kishë dhe Qendër do të do të jetë derë dhe zemërpur për të gjithë, si Zemra e Krishtit, si jeta dhe vepra madhore e së Lumes Nënës tonë Tereze. E gëzojmë shpirtin të gjithë!

Historik i shkurtër i Kishës “Zemra e Krishtit” dhe qendrës pastorale “Nëna Tereze” në Viti

Fjalimi i Don Lush Gjergji, famullitarit të Binçës, ditën e bekimit të Kishës

Inderuari dhe i dashuri Imzot Dodë Gjergji, vëllezër meshtarë, motra rregulltare, besimtarë të dashur, autoritete komunale, miq dhe dashamirë,

Më lejon që shkurtimisht ta paraqes historikun e Kishës dhe Shenjtërores “Zemra e Krishtit” dhe të Qendrës Pastorale “Nëna Tereze” në Viti, sot, në ditën e bekimit dhe të përrimit të këtyre objekteve.

Qysh gjatë sundimit dhe diktaturës serbe Kisha Katolike e Binçës, famullia e “Shna Ndout” e bëri një kërkesë organeve kompetente komunale në Viti për një lokacion për ndërtimin e Kishës Katolike në qendrën komunale, por kuptohet, pa sukses, bile për


t’ na përbuzur, edhe pa kurrfarë përgjigje.

Kërkesën e kemi përsëritur pas Luftës së lavdishme të vitit 1999, më datë 17 dhjetor 1999 Këshillit Komunal Viti, Sektorit për Urbanizëm, “për një lokacion të përshtatshëm për ndërtimin e Kishës Katolike në qendrën tonë komunale për nevojat shpirtërore-kulturore të besimtarëve katolikë në Viti”.

Këtë kërkesë e kanë nënshkruar 44 familje katolike me 359 anëtarë në Viti.

Kuvendi i Komunës së Vitisë mori vendimin për ndarjen e vendit për ndërtimin e Kishës Katolike të “Tregu i gjelbër” më 12 korrik 2002. Fletëposedimi u dha më 16 dhjetor 2002. Aktvendimi mbi dhënie e lejes së ndërtimit u dha më 14 nëntor 2003.

Bekimin i gurrhemelit e bëri



Kisha e Zemrës së Krishtit në Viti

Krezmimi në famullitë tona

Si çdo vit, ashtu edhe sivjet, pas përgatitjes përkatëse për vite me radhë në mësim besimi, shumë të rinj e të reja nëpër famullitë tona morën sakramentin e krezmimit, i cili është një nga tri sakramentet e iniciacionit të krishterë. Mund të themi se sidomos gjatë muajve maj dhe qershor, me rastin e krezmimit në famullitë tona kishte gëzim dhe festë, sepse të rinjtë tanë ishin të gatshëm të marrin mbi vete detyrat dhe përgjegjësinë të jetojnë si dëshmitarë të Krishtit.

Kjo vërehej edhe me përgatitjet që ishin bërë për këtë ditë fakt ky që e gëzonte pa masë edhe ipeshkvin tonë Imzot Dodën, i cili për herë të parë krezmonte si Bariu i kësaj Kisha. Ipeshkvi në fjalët e rastit i inkurajonte kandidatët, nunat e nunet, por edhe familjarët e tyre që tani e tutje edhe më tepër të japin dëshminë e jetës së krishterë. Ipeshkvi i falënderoi edhe meshtarët dhe motrat e nderit për punën që bëjnë në famullitë përkatëse.

Në fuqinë e këtij sakramenti

të krezmuarit marrin Shpirtin Shenjt, të cilin, ditën e Krështajëve Krishti ua dërgoi apostujve. Të përfurcuar me Shpirtin Shenjt të rinjtë tanë morën vulën e pashlyer të Zotërisë, prandaj sakramenti i krezmimit është i papërsëritshëm.

Në Shkrimin Shenjt lexojmë: "Kur apostujt dëgjuan në Jeruzalem se Samaria e kishte pranuar Fjalën e Hyjit i dërguan atje Pjetrin e Gjonin. Këta zbriten atje, u lutën për ta që ta merrnin Shpirtin Shenjt, sepse ende nuk kishte zbritur mbi asnjërin ndër

ta; ata vetëm ishin të pagëzuar në Emër të Jezusit Zot. Atëherë vunë duart mbi ta dhe ata morën Shpirtin Shenjt" (Vap 8, 14-17).

Sakramenti i krezmimit i përforcon të pagëzuarit të vazhdojnë rrugëtimin e rritjes në fe, për më tepër, fillimin e dhënies së dëshmisë më të thellë të besimit në Krishtin. Pra, me marrjen e dhuratave të Shpirtit Shenjt besimtarët aftësohen shpirtërisht që të kenë mundsinë t'i përngajnë Krishtit në çdo hap të jetës së vet. Urimë!

Shtatorja e Nënës Terezë në Zym

Në ditën e shën Ndout (13 qershor 2007) në Zym u vendos shtatorja e Nënë Terezës. Ishe kjo një dëshirë e kamotshme e zymjanëve që në fshatin e tyre të vendoset shtatorja e kësaj nëne. Pas punimeve të shumta për rregullimin e ambientit nëpër lagje të ndryshme, u gjet momenti që të vendoset kjo shtatore. Për realizimin e kësaj ideje u përkujdes Kristë Dulaj dhe në bashkëpunim me kurbetçarët Luigj Prenklushaj, Kolë Berisha e Lekë Lekaj e të tjerë nga lagjia e Berishës. Zbulimin e shtatores e bëri patër Ndue Kajtazi, i lindur në këtë famulli. Mes të tjerash foli për figurën e Nënë Terezës.

U kremtua Shën Antoni i Padovës



Mesha në Gjakovë

Më 13 qershor 2007 u kremtua me shumë solemnitet Shën Antoni i Padovës në të gjitha famullitë kushtuar këtij shenjt i nderuar. Në Prishtinë meshën e udhëhoqi ipeshkvi ynë Mons. Dodë Gjergji, në Gjakovë Don Kolë Thaqi, në Bincë Don Marjan Demaj dhe në Gllorian Don Jeton Thaqi.

Lajme shkurt

Në Prizren, prej 6 e deri më 8 qershor 2007, u mbajt takimi i Caritaseve regionale të Evropës Juglindore.

Ishtin të pranishëm përfaqësues nga Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina Bullgaria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova. Tema qendrore e këtij takimi ishte shqyrtimi i metodave të themelimit dhe formimit të caritaseve të famullive; në këtë kuadër diskutimesh dhe përvashash u shqyrtuan edhe sensibilizimi, animimi dhe edukimi që duhet të ofrojnë caritas-i përmes punëtorëve dhe vullnetarëve të tyre. Takimin e përshëndeti edhe ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, i cili para pjesëmarrësve të takimit theksoi rëndësinë e Caritasit në jetën e Kishës dhe të shoqërisë.

40-vjetori i meshtarisë së Don Anton Kçirës

Të dielën, më 10 qershor 2007, në Detroit (në SHBA) Don Anton Kçira kremtoi 40-vjetorin e shugurimit meshtarak. Don Antoni është lindur në Moglicë, në famullinë e Gjakovës, më 17.06.1939. U shugurua meshtarë në Gjakovë, më 29 qershor 1967. Meshën e parë e kremtoi në Gjakovë, më 2 korrik 1967. Shumë vjet ka shërbyer në famullinë e Gllorianit. Në vitin 1979 shkoi në Amerikë, në Detroit, ku edhe sot u shërben besimtarëve shqiptarë të Amerikës. URIME!

25-vjetori i meshtarisë së Don Nikë Ukgjiut

Të shtunën, më 16 qershor 2007, në kishën e Zojës së Këshillit të mirë të Kalaja e Shkodrës, Don Nikë Ukgjiu e kremtoi jubileun e argjendit të meshtarisë 25-vjetorin e shugurimit të vet meshtarak. Don Nika është lindur më 19 janar 1957 në Dugaievë, në famullinë e Gllavicës (afër Klinës, në Kosovë). Gjymnazin klasik e përfundoi në vitin 1976 në seminarin Paulinum në Subotice. Studimet filozofiko-teologjike i kreu në Zagreb. Në vitin 1982 u shugurua prift për Kryediocezin e Tivartit. Si meshtar punoi në Plavë, Guci, Shkrel, Shën Gjergj (MZ), dhe në Shkodër. Në vitin 2002 në Universitetin e Zagrebit mbrojti temën e doktoraturës: "Shqiptarët katolikë në Shqipërinë e Veriut dhe në Mal të Zi të sotëm gjatë pushtimit osman në shek. XV-XIX". Që nga viti 1998 është ligjërues i lëndës së historisë pranë institutit Filozofiko-Teologjik në Shkodër. URIME!

Pensionohet Motra Alojzina Tomasheviq

Pas një pune 41-vjeçare në spitalin e Gjakovës si instrumentiste, këto ditë ka dalë në pension dhe do të transferohet në Zagreb. Motrën e falënderojmë për punën e pakursyer në përkujdesen e pacientëve të shumtë dhe i urojmë jetë të gjatë e shpërbleftë për punën e bërë.



Foto me kandidatët e krezmuar në Katedralën e Prizrenit, 2007

Shtegtimi tradicional i të rinjve në Letnicë, 26 maj 2007

Muaji Maj është i kushtuar Zojës së Bekuar Virgjërës Mari. Kisha jonë e Kosovës që nga mbarimi i Luftës në Kosovë e ka bërë tradicionale këtë shtegtim si përfundim i muajit Maj dhe takim i të rinjve në lutje të Shenjtënoja e Zojës. Morën pjesë të

gjitha famullitë tona. Meshën e udhëhoqi Mons Dodë Gjergji, ipeshkëv, i cili ndër të tjera theksoi se duhet të kuptojmë se jeta nuk është lojë, por përgjegjësi. Ai që në rini luan me jetën, do të luajë jeta me të në pleqëri. Le të marrim shembull nga Zonja e Bekuar,

e cila tërë jetën e vet e vuri në shërbim të Zotit. Jeta është dhuratë e Zotit, andaj duhet ta ruajmë dhe ta jetojmë në përkim me vullnetin e Tij. Pas meshës ishte një program argëtues ku morën pjesë të rinjtë nga Ferizaji, Glloriani dhe Pjetroshani.

Mesha në Letnicë gjatë shtegtimit tradicional të të rinjve



Bushi në audiencë te Papa Benedikti XVI

Gjendja e rëndë e të krishterëve në Irak, temë e takimit të Papës dhe presidentit Bush



G.W. Bush në audiencë te Papa

Presidenti Bush gjatë turneut nëpër Evropë, më 9 qershor u takua në Vatikan me Papën Benediktin XVI. Ishte ky takimi i parë i tyre, ç'prej se Joseph Ratzinger është zgjedhur papë. Temat e bisedës ishin të larmishme, prej punës dhe vendimeve të G8 ku u diskutua ndihma e shteteve të zhvilluara dhënë vendeve afrikane, mbrojtja raketore në Evropën Lindore, çështja e Kosovës dhe në veçanti ishte brenga e Papës për gjendjen e rëndë të të krishterëve në Irak.

Të krishterët në Irak

Kur është fjala për të krishterët në Irak, duhet theksuar terrorin që e përjetojnë qdo ditë nga grupet ekstremiste të sekteve të ndryshme islame atje.

Që prej invazionit amerikan në Irak, të krishterët kanë qenë caku i shumë sulmeve, prej shkatërrimit të kishave, vrasjes së personelit kishtar, dëbimit me dhunë të të krishterëve etj. Të krishterët në Irak datojnë që nga shekulli i parë, ata janë shumë krenar se fenë e krishterë e kanë marrë nga apostujt, e në veçanti nga shën Toma apostull. Në Irak dhe në vendet përreth, para ardhjes së islamit kishte mbi 80 milionë të krishterë, në veçanti të gjithë asirët ishin të kristianizuar. Të krishterët asirianë (që nuk janë arabë) dhe të krishterët tjerë arabë, që nga shekujt e parë ndahen në tri kisha të ndryshme: Kisha Nestoriane, Kisha e Kaldejës dhe Kisha ortodokse siriane. Nga këto tri kisha, Kisha e Kaldejës është në bashkim të plotë me Kishën Katolike dhe ka mbi 1500 000 besimtarë në gjithë botën. Në Irak, deri në fillim të invazionit (2003) kishte mbi 800.000 besimtarë, ndërsa sot ai numër është zvogëluar në afro 20.000. Pra ka qenë një eksod i paparë i të krishterëve atje dhe një dhunë e madhe kundër tyre për ta lëshuar vendin ose në raste

më të rënda edhe për t'u konvertuar me dhunë në fenë islame, siç u shpreh Prefekti i Kongregatës për Kishat Lindore, Kardinali Injac Musai Daud.

Vetëm në muajin e fundit janë rrëmbyer shumë meshtarë, një ndër ta edhe rektori i seminarit teologjik, Ati Sami Al-Rais, është vrarë meshtari Atë Ragheed Ganni dhe tre diaconë në Mosul, kurse një kishë në lagjen Dora të Mosulit ishte cak i sulmeve terroriste. Gjatë kësaj kohe u shkatërrua edhe një kishë e Shën Gjoni Pagëzuesit, ndërsa kisha e Shën Jakobit në vendin e quajtur Hay Al Asya është shndërruar me dhunë në xhami. Nuk është kjo e gjitha që iu ndodh të krishterëve, tash se fundit nëpër Bagdat qarkullon një letër që thirrte në imamin radikal shiit Moqtada al Sader që të gjitha gratë e krishtera duhet të bartin shaminë, se përndryshe do të pësojnë dënime të mëdha. Në këtë letër shkruan edhe: "ato që nuk bartin shaminë, janë të pandershme, të poshtira, fyejnë Allahun dhe profetin e tij..."

Apelet e Papa Benedikti XVI për paqe dhe dialog në Irak dhe Lindjen e Mesme

"Krim pa kurrfarë kuptimi" – kështu e quan Papa vrasjen e një meshtari kalde dhe të tre diaconëve të tij që ndodhi më 4 qershor 2007. Në një telegram ngushëllimi, drejtuar ipeshkvit kalde të Mosulit, Imzot Paul Faraj Raho, Benedikti XVI, thellësisht i hidhëruar, thekson pjesëmarrjen e Tij në dhimbjen e bashkësisë së Mosulit e lutet që ky flimim t'i frymëzojë zemrat e të gjithë njerëzve vullnetmirë, t'i refuzojnë rrugët e urrejtjes e të dhunës e të punojnë për bashkëpunim e pajtim, drejtësi e paqe në Irak.

Vrasja e katër njerëzve të Kishës dëshmon edhe një herë për kushet tragjike në të cilat

jetojnë të krishterët irakianë. Atë Ragheed dhe tre bashkëpunëtorët e tij humben jetën pak pas përfundimit të Meshës të së dielës, përpara Kishës kushtuar Shpirtit Shenjt, famullitar i së cilës ishte meshtari i vrarë.

Se Papa është prekur shumë me gjendjen e rëndë të të krishterëve në Irak, dëshmojnë edhe reagimet e tij të njëpasnjëshme, në takimet e tij me shumë njerëz të të gjitha institucioneve, shtetërore dhe fetare.

Papa në Lindjen e Mesme duhet të çlirohet nga sëmundja vdekjeprurëse e diskriminimit fetar, historik dhe gjeografik

Më 21 qershor 2007 Papa kishte pritur pjesëmarrësit e takimit dyditor semestral të Bashkimit të Veprave të Bashkimit të Asistencës për Kishat Lindore (ROAKOS), dhe aty e theksoi se "Papa në Lindjen e Mesme duhet të çlirohet nga sëmundja vdekjeprurëse e diskriminimit fetar, historik dhe gjeografik." Mandej Papa vlerësoi se Kisha në Irak po i nënshtrohet një martirizimi të vërtetë në emër të Krishtit. Për këtë gjendje tejet të dhunshme, Papa nuk mund të jetë i qetë, por apelon tek organet kompetente të vendosin paqen dhe dialogun. Në fund të takimit Papa tha: "Së bashku me secilin nga ju, duke e ndjerë veten të bashkuar me të gjitha Kishat dhe bashkësitë e krishtera, por edhe me ata që nderojnë emrin e Zotit dhe e kërkojnë me sineritet, e me të gjithë njerëzit vullnetmirë, dëshiroj të trokas ristas në zemrën e Hyjit, Krijues e Atë, për t'i kërkuar, me besim të pakufishëm, dhuratën e paqes. Trokas edhe në zemrën e të gjithë atyre që kanë përgjegjësi, që ta kryejnë detyrën e vështirë të sigurimit të paqes për të gjithë, pa dallim, duke e çliuar nga sëmundja

vdekjeprurëse e diskriminimit fetar, kulturor, historik dhe gjeografik."

Në të njëjtën ditë Papa Benedikti XVI priti në audiencë Katolikosin, Patrikun Mar Din-khr IV i Kishës Asire në Lindje. Edhe në këtë takim Papa me shqetësim të thellë e përmendi situatën e të krishterëve në Irak duke vënë në dukje kontributin e madh të të krishterëve irakian, kontributi i të cilëve ishte dhe është i rëndësishëm dhe fort i çmuar në shpalljen e ungjillit, kurse sot vuajnë shpirtërisht

dhe materialisht. Në Irak – kujtoi Ati i Shenjtë – familjet dhe bashkësitë e krishtera e ndjejnë gjithnjë e më shumë presionin e pasigurisë, të agresionit e jo më pak të braktitjes. Shumë prej tyre nuk shohin asnjë rrugëdalje tjetër, veç largimit nga vendi. Në fundin e takimit Ati i Shenjtë shprehu shqetësimin për situatën e krijuar dhe njëkohësisht u solidarizua me të gjithë barinjët e besimtarëve të atyre trojeve, që vijnë të qëndrojnë në këto vise duke e paguar me çmim të lartë.

Papa ja drejtoi G8 ftesën që lufta kundër varfërisë të jetë në qendër të bisedimeve në Hailegendam

Të vihet tema e varfërisë në këtë rang të lartë të G.8: këtë i kërkojë me forcë Papa udhëheqësve të 7 vendeve më të industrializuara dhe të Federatës Ruse, që moren pjesë në samitin e Hailegendam. Thirrja e Benediktit XVI bëhet përmes letrës drejtuar kancelares së Gjermanisë, Angela Merkel, me rastin e fillimit të presidencës gjermane të Bashkimit Evropian e të G8, në dhjetorin e kaluar.

Po kujtojmë pikat kryesore të këtij mesazhi: Për Papën, objektivi për zhdukjen e varfërisë së skajshme brenda vitit 2015, është një nga detyrat më të rëndësishme të kohës sonë. E, në këtë drejtim – thekson Ati i Shenjtë – G8 duhet të luajë rol udhëheqës. Por Selia e Shenjtë është e shqetësuar nga paaftësia e vendeve të pasura për t'u ofruar vendeve të varfëra, posaçërisht atyre të Afrikës, kushte të përshatshme financiare e tregtare, që do të krijojnë mundësi për zhvillim afatgjatë. Nuk është fjala për koncesione – thekson Ati i Shenjtë – por për një detyrë morale me peshë e të pakushtëzuar, të bazuar në faktin se të gjithë njerëzit i përkasin së njëjtes familje njerëzore. Për vendet e varfëra – vijon Papa – duhen siguruar kushtet komerciale të favorshme si dhe hyrja pa pengesa e pa rezerva ndër tregje. Sipas Benediktit XVI, duhen marrë masa paraprake për shlyerjen e plotë e të pakushtëzuar të borxhit të jashtëm të këtyre vendeve, duke parandaluar edhe rrezikun e përsëritjes së borxheve të kësaj natyre. Papa i nxit vendet e industrializuara t'i respektojnë impenjimet e marra për luftën kundër varfërisë e kundër pandemive, posaçërisht, kundër Sidës, tuberkulozit, malaries e sëmundjeve të tjera tropikale, pa kërkuar lëshime me karakter juridik ose ekonomik. Pohon,

kështu, me forcë se bashkësia ndërkombëtare duhet të vijojë përpjekjet për reduktimin e ndjeshëm të tregtisë së armëve, të trafikut ilegal të lëndëve të para të çmuara e të transferimit të kapitaleve nga vendet e varfëra. Njëkohësisht duhet të impenjohet për zhdukjen e praktikës së riciklmit të parave që burojnë nga vepra kriminale si dhe të korrupsionit të funksionarëve të vendeve të varfëra. Është fjala për arritje që lidhen pazgjidhshmërisht me paqen e sigurinë në botë. Por t'i kujtojmë fjalët që u tha vetë Benedikti XVI, më 19 majin e kaluar, anëtarëve të Fondacionit "Centesimus Annus – Pro Pontifice". Duke kujtuar 40-vjetorin e *Populorum progressio* të Palit VI, Benedikti XVI nënvizoi se zhvillimi nuk duhet reduktuar vetëm në zhvillimin ekonomik, sepse për të qenë i vërtetë, duhet të jetë i plotë, dmth duhet ta ketë mirë parasysh përparimin e çdo njeriu e të njeriut në përgjithësi: "Vëmendja për kërkesat e vërteta të njeriut, respekti për dinjitetin e çdo njeriu, kërkiti i singertit i së mirës së përbashkët, janë parimet frymëzuese që është e mira të kihen parasysh, kur bëhen plane për zhvillimin e një kombi. Por, për fat të keq, nuk ndodh gjithnjë kështu. Në shoqërinë e sotme të globalizuar, vërehen shpesh çekuilibre paradoksale e dramatike. Në fakt, kur flitet për përgjindjet e zhvillimit ekonomik, kur analizohen problemet që lidhen me përparimin modern, pa përjashtuar ndotjen e ndjeshme të mjedisit dhe shpenzimin pa përgjegjësi të burimeve natyrore e ambientale, duket qartë se vetëm një proces globalizmi i vëmendshëm ndaj kërkesave të solidaritetit, mund t'i sigurojë njerëzimit një ardhmëri me mirëqenje e paqe të vërtetë për të gjithë".

Tony Blair bëhet katolik?

Takimi i Tony Blair me Benediktin XVI javën e kaluar në Vatikan ka zgjuar kureshtjen e shumë mediave botërore e në veçanti atyre britanike. Edhe pse ka vetëm indikacion, përflitet gjithandej se kryeministri britanik që këto ditë largohet nga posti i kryeministrit, do të përqafojë Kishën Katolike.

Në një atmosferë shumë të përzemërt, Papa priti më 23. 06. 2007 në audiencë kryeministrin britanik Tony Blair, që arriti në Romë pak orë pas largimit nga Brukseli, ku mori pjesë në takimin e rangut të lartë, në qendër të vëmendjes së opinionit botëror. "Dëgjova se u krye me sukses" – i tha Papa kryeministrit britanik, pasi shtrënguan duart. 'Po' – u përgjigj Blair – por ishte një natë tepër e gjatë. Përfundoi sot në mëngjes, në orën 5:30". Këto fjalë u shkëmbyen në Sallën e Fronkës, para se të fillonte bisedimi privat.

Gjatë këtij bisedimi – sipas komunikatës së Sallës së Shtypit të Vatikanit – u fol për disa aspekte të kontributit të rëndësishëm që ka dhënë Tony Blair gjatë dhjetë vjetëve të qeverisjes së tij. Pastaj Papa dhe kryeministri britanik u përqendruan te situata ndërkombëtare, pa harruar çështjet posaçërisht delikate të konfliktit në Lindjen e Mesme dhe të ardhmërisë së Bashkimit Evropian, menjëherë pas samitit të Brukselit. Së fundi, si shkëmbyen opinionet për disa ligje, miratuar kohët e fundit nga parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar, Papa i bëri Tony Blairit urimet më të mira në prag të largimit nga detyra e kryeministrit, duke pasur parasysh se Blair ka shprehur dëshirën të impenjohet në mënyrë të posaçme për paqen në Lindjen e Mesme dhe për dialog ndërfetar.

Menjëherë pas bisedimit privat, u hapën dyert e Bibliotekës së Benediktit XVI dhe hyri delegacioni që shoqëronte Blairin: në të bënin pjesë 11 personalitete si dhe bashkëshortja e kryeministrit britanik, Sheri. Blairi i dhuroi Papës tri fotografi të epokës, të kardinalit të madh

Tony Blair në audiencë te Papa Benedikti XVI



Jahn Henry Newman, anglikan i kthyer në Kishën Katolike në shekullin e kaluar. Njëra nga fotot ishte e nënshkruar nga vetë Kardinali Newman, ndërsa Benedikti XVI u dhuroi të pranishmëve medalje të papnisë dhe rruzare. Pasi u përshëndetën me Papën, Blair zbriti në katin e dytë të Pallatit Apostolik, ku u takua me kardinalin Tarcisio Bertone, Sekretar i Shtetit të Shenjtërisë së Tij. (Radio Vatikan, 23. 06. 2007)

Mediat britanike dhe botërore mbi udhëtimin e kryeministrit britanik Tony Blair në Vatikan

Gazeta *The Guardian*, duke u bazuar në burime anonime në Londër dhe në Romë shkruan se si kryeministri britanik Tony Blair, i cili i përket kishës anglikane, ka vendosur të kalojë në fenë katolike. Tony Blair shumë

shpejt e lëshon detyrën e kryeministrit dhe fill pastaj edhe zyrtarisht do të bëhet katolik.

The Daily Telegraph shkruan se si z. Blair sigurisht do të fillojë procedurën formale për t'u bërë anëtar i kishës katolike menjëherë sa ta dorëzojë detyrën e premierit. "Shumë njerëz e kanë të qartë që kjo do të ndodhë", shkruan gazeta dhe shton se si gruaja e Blair-it dhe katër fëmijët e tyre janë të pagëzuar në kishën katolike.

Tony Blair ka një kohë që ka shfaqur simpatinë e vet për Kishën Katolike. Madje edhe disa herë gjatë mandatit të tij kishte marrë pjesë në meshë të dielave në Kishën Katolike bashkë me bashkëshorten e tij Cherien dhe fëmijët që janë katolikë. Me kushtetutën e Britanisë kryeministri s'mund të jetë i besimit katolik. Kjo ka bërë që Blair mos të ekspozohet

teper nëpër mesha, sepse do të kishte pasoja për postin e tij dhe partinë e tij në pushtet. Tani kur kryeministri është në përfundimin e mandatit të tij, mund të arrihet një përqafim i plotë i familjes Blair me Kishën Katolike.

Që nga koha e Mbretit të Anglisë Henrikut VIII (1491-1547), të gjithë kryeministrat e Anglisë ishin anglikanë, e tani Blair mund të jetë ai që do të thyejë një traditë e të bashkojë me Kishën Katolike.

Ditën e takimit me Papën, Blair i kishte thënë BBS-së se "ende nuk është definitiv" konvertimi i tij. Gjërat nuk do të jenë edhe aq të lehta, kur kihet parasysh se kthimi i tij do të zgjojë shumë shpirtira të Kishës Anglikane, madje shumë prej tyre pohojnë se do të pasojë një valë e konvertimeve të simpatizantëve të Blairit dhe të partisë

së tij laboriste. Ditën e takimit me Papën Blair ndihej paksa i emocionuar dhe i shqetësuar. Atë ditë Kisha Katolike i festonte dy shenjtërit Gjon Fisher dhe Tom Mor, dy anglezë, njëri ipeshkëv i Rochesterit, kurse i dyti lord-kancelar i Anglisë. Edhe njëri edhe tjetri në vitin 1535 u martirizuan duke pranuar që më mirë t'ju prehet koka se sa të lejojnë dhe të miratojnë divorcin dhe planifikimet martesore sipas qejfit të mbretit të tyre, për shkak të cilave në atë kohë Henrik VIII e ndau Kishën nga Roma dhe e themeloi Kishën Anglikane. Që nga ajo kohë Kishën Anglikane e Udhëheqë Mbretëresha e Anglisë dhe ajo në konsultim me kryeministrin i cakton ipeshkvijtë nëpër seli ipeshkvore të Anglisë.

Por, sot askush më nuk beson se konvertimi i Blairit do të ketë pasoja enorme siç ishin në kohën e Fisherit dhe Morit. Jeta e sotme në Britani ndërron nga koha e atëhershme, madje kohët e fundit kemi një numër të madhe rikthimesh në Kishën Katolike, jo të vetë besimtarëve të thjeshtë, por edhe të priftërinjve, të cilët janë të pakënaqur me mënyrën se si Kisha Anglikane bënë reformat përbrenda strukturave kishtare, shugurimin e grave etj etj. Mos të harrojmë të theksojmë se njëri ndër kardinalët e njohur të Kishës Katolike ishte një klerik anglikan i kthyer në katolicizëm, John Henry Newman. Nuk do të ishte asgjë e jashtëzakonshme që një kryeministër britanik në fund të ushtrimit të detyrës së tij të bëhet katolik, madje disa pohojnë që dëshira e Blairit është edhe të bëhet diakon permanent, që do të ishte një njeri më intimisht i lidhur me shërbesën liturgjike katolike.

Papa Benedikti XVI priti në audiencë prymasit ortodoks të Qipros, Krizostomi II

(16. 06. 2007) "Na pret një vepër madhore, që i kapërcen forcat njerëzore arritja e bashkimit të plotë, aq të dëshiruara nga Krishti", këshuto u shpreh Benedikti XVI duke e pritur, plotë gëzim e mirënjohje, në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, primatein e Justinianës së Re dhe Qipros, Krizostomin II, Bari i një Kishë të lashtë e të ndritur të Lindjes – siç u shpreh Papa. Këtë vizitë Papa e quajti 'dhuratë Zotit të durimit e të ngushtëllimit': "Dhuratë durimi sepse, pavarësisht nga përçarjet shekullore udbet e ndryshme e vështirësive në mbijlljen e plagëve të dhimbshme, Zoti nuk pushoi s'i udhëbëguari bapat tanë në rrugën e unitetit e të pajtimit. Ky është ngushtëllim i madh për ne të gjithë, sepse takimi i sotëm është pjesë e një udhe në të cilën bëhet gjithnjë më këmbëngulës kërkimi i bashkimit aq të dasbur nga Krishti: 'ut omnes unum sint' – që të gjithë të jenë një".

Pasi kujtoi zanafillën e Kishës së Qipros, të pasur me shenjtëri si Epifani, Barnaba, Ati i Shenjtë vuri theksin mbi sfidat e problemet e përbashkëta aktuale të të dyja kishave:

"Si atëherë, ashtu edhe sot, duhet të jemi vigjilentë, për të ruajtur popullin e Zotit nga profetë të rremë, nga gabimet e nga cektësia e propozimeve, që nuk përkojnë me mësimin e Mjeshtrit Hyjnor, Shëlbuesit tonë të vetëm", tha Papa.

Kryepeshkopi Krizostomi II, duke i bërë jehonë shqetësimeve të Benediktit XVI, vuri në dukë se Evropa, djep i qytetërimit perëndimor dhe seli e lumnueshme e shpirtit të krishterë, po kalon një periudhë krize dhe corientimi, ateizmi e dyshimi, shekullarizmi e dekadence. Si shoqëria ashtu edhe njeriu i kohëve tona ka etje për të vërtetën, kërkoi të gjejë kuptimin e jetës – theksoi kryepeshkopi qipriot, dhe në vijim i ftoi Kishat e Evropës t'i përgjigjen të bashkuara kësaj kërkesë të shumë burrave e grave të kohës sonë.

Si kujtoi se kjo vizitë në Vatikan bëhet në prag të 35-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Republikës së Qipros, Krizostomi II i kërkoi Papës të lutet për kthimin e paqes e të bashkimit në Ishull ku të drejtat e njeriut shkenen e Kisha vuan, por edhe rezistion me dinjitet të plotë.

Nënshkrimi i Deklaratës për bashkimin e të krishterëve dhe thirrja për paqe në Tokën e Shenjtë

Në përfundim të vizitës, në një atmosferë të ngrohtë e vël-lazërore u nënshkrua Deklarata dypalëshe, në të cilën theksohen impenjimet dhe shpresat për bashkimin e plotë të të krishterëve, duke ju përgjigjur kështu kërkesave të kohës. Në Dokument kujtohen disa nga problemet aktuale më urgjente, si mbrojtja e të drejtave të njeriut, duke u nisur nga liria fetare; u bëhet thirrje t'i ulin armët të gjithë atyre që ngrenë dorë kundër vëllait; kërkohet që të sigurohet paqja në Lindjen e Mesme e që Evropa të mos kufizohet në një bashkëpunim thjeshtë ekonomik, por të ngrihet mbi baza të shëndosha kulturore dhe etike e të mos e harrojë kurrë përmasën fetare. Kujtohen, pastaj, sfida e biotikës, e mbrojtjes së ambientit, e varfërisë, e urisë dhe e sëmundjeve. Deklarata përfundon duke iu lutur Zotit të historisë që kumtimi ungjillor i shëlbimit të arrijë tek brezi i ri e të jetë dritë për të gjithë njerëzit. Para se të largohet nga Vatikanin, Krizostomi II u lut së bashku me Benediktin XVI në kapelën Nënë e Shëlbuesit. (Radio Vatikan – shqip).

Dukuria e së shenjtës dhe re

■ SHKRUAN:

Don Robert Kola

Dukuria e religjionit është një ndër dukuritë më të jashtëzakonshme njerëzore. Studiuesit e religjionit kanë arritur të përfundimi se njeriu që nga agimi i paraqites së tij, na shfaqet si qenie religjioze. Njeriu, që nga fillimi, na shfaqet si qenie simbolike, me duar të hapura, me shikim të ngritur që kërkon të depërtojë në fshehtësinë e gjithë asaj që e rrethon. Nëse në të kaluarën e njeriut nuk mund të hasim "shoqëri pa religjion" siç vërente H. Bergson-i, sot, apo siç heton një studiues tjetër i religjionit R. Guardini, se "kup-timi i historisë së ardhshme do të varet nga njohja dhe pranimi i elementit religjioz". Religjioni është boshiti i jetës së njeriut, është roja e traditës, është çelësi i jetës së njeriut. Religjioni është pragu përmes të cilit hyjmë në universin e pashtershëm simbolik të njeriut.

PËRFTYRIMI DHE PERCEPTIMI I RELIGJIONIT

Kjo është themeluar religjioni? Si është njëra prej pyetjeve, e cila i ka vënë në lëvizje studiuesit e kohërave të ndryshme për ta hetuar këtë fshehtësi. Botëkuptimet e tyre rreth kësaj pyetjeje janë të ndryshme. Mjafton këtu t'i cekim vetëm disa sosh, të cilat ndikuan edhe në ngritjen e sistemeve të botëkuptimit në shoqëri. Religjioni u përcaktua si "hipostazim i idealeve të njeriut" (Feuerbach); shihet edhe si "sublimim i instinktit" (Freud); hotohet se religjioni është themeluar edhe nga "ndjenja kundër të fortit" (Nietzsche); dikush mendonte se religjioni u krijua nga "frika ndaj natyrës" (Hume); ndonjë tjetër shkonte se religjioni është krijuar nga "dredhia e meshtarëve" (Marx) etj.

Këta dhe studiues të tjerë të ngjashëm i afroreshin religjionit për ta zbrëthyer duke u nisur nga pikëpamjet dhe fushat e ndryshme të botëkuptimeve të tyre.

Mirëpo, studiuesi i njohur M. Eliade, përfundimisht hodhi dritë mbi dukurinë e religjionit, kur nga vëzhgimet e tij të paktësueshme në këtë fushë erdhi në përfundim se "ti afroshesh dukurinë së religjionit duke u nisur qoftë nga filozofia, psikologjia apo sociologjia, do të thotë të traditosh elementin themelues të religjionit që është e shenjtja (sacrum). Elementi themelues i religjionit është e shenjtja".

“Në kuptimin më të ngushtë të fjalës, nocioni "sacrum" nënkupton: "atë që është e ndarë nga objektet tjera, që është e pashkelur dhe që kërkon një nderim religjioz" (A. Lalande). Për sa i përket përdorimit të këtij nocioni, shtrirja e tij është e gjerë dhe e larmishme. Përdoret për vende: mali i shenjtë, vendi i shenjtë; përdoret për kohërat: ditë e shenjtë, muaji i shenjtë, vit i shenjtë; përdoret për personat: njeri i shenjtë; për figurat etj. Për të hetuar domethënien e nocionit sacrum, duhet të kërkojmë ndihmë edhe nga filologjia. Fjala sacrum rrjedh nga fjala latine sacer, fjalë kjo që rrënjën e vet e ka në fjalën sancire, që nënkupton t'i japësh formën e duhur dhe pa të meta ndonjë gjëje. Kjo fjalë, sancire, aplikohet edhe për ligje, institucione dhe veprime të ndryshme. Falë këtij nocioni të fjalës latine sancire, del më i kuptueshëm nocioni origjinal i fjalës sacrum, e cila për burim ka nocionin e gjuhës indoevropiane: sak, që do të thotë: "eksistencë, qenësi, të qenit real". Këto nocione: sacer, sak, sacrum, nga e cila e merr kuptimin fjala e shenjtë, na bëhet me dije se si themeli i të shenjtës përfshin dhe përshkuan tërë ekzistencën dhe qenësinë në tërësi.

Sikundër që, ndaj të bukurës përgjigjemi me art, ndaj të mirës me etikë, ndaj qenies me metafizikë, ndaj religjionit duhet të përgjigjemi me të shenjtën. E shenjtja na shfaqet si simbol dhe monument i qenies, apo siç na bën me dije K. Hemmerl, numinoziteti që shpërthen nga genia arrihet përmes "hirit të lirë". Ky studiues hetoi se: "qenësia e së bukurës apo e së vërtetës në qenie, është e pranishme përmes shkëlqimit të tyre. Mirëpo, prania e së shenjtës në qenie është e pranishme përmes simbolit dhe monumentit. E shenjtja është memoria apo kujtesa e të qenit që na bën të njohim qenësinë e saj, njohje kjo e cila na orienton gjithmonë kah zanafilla e jetës, e cila na shfaqet në trajtën e tremendur et fascinum dhe e cila përherë mbetet e fshehur. Prandaj, kërkimi i shkaktit të shenjtës në qenie mbetet përherë mister që hapet vetëm përmes hirit të lirë".

DEFINICIONI I TË SHENJTËS

Në kuptimin më të ngushtë të fjalës, nocioni "sacrum" nënkupton: "atë që është e ndarë nga objektet tjera, që është e pashkelur dhe që kërkon një nderim religjioz" (A. Lalande). Për sa i përket përdorimit të këtij nocioni, shtrirja e tij është e gjerë dhe e larmishme. Përdoret për vende: mali i shenjtë, vendi i shenjtë; përdoret për kohërat: ditë e shenjtë, muaji i shenjtë, vit i shenjtë; përdoret për personat: njeri i shenjtë; për figurat etj.

Për të hetuar domethënien e nocionit sacrum, duhet të kërkojmë ndihmë edhe nga filologjia. Fjala sacrum rrjedh nga fjala latine sacer, fjalë kjo që rrënjën e vet e ka në fjalën sancire, që nënkupton t'i japësh formën e duhur dhe pa të meta ndonjë gjëje. Kjo fjalë, sancire, aplikohet edhe për ligje, institu-

cione dhe veprime të ndryshme. Falë këtij nocioni të fjalës latine sancire, del më i kuptueshëm nocioni origjinal i fjalës sacrum, e cila për burim ka nocionin e gjuhës indoevropiane: sak, që do të thotë: "eksistencë, qenësi, të qenit real".

Këto nocione: sacer, sak, sacrum, nga e cila e merr kuptimin fjala e shenjtë, na bëhet me dije se si themeli i të shenjtës përfshin dhe përshkuan tërë ekzistencën dhe qenësinë në tërësi.

TRANSCENDENCA E TË SHENJTËS

E shenjtja i referohet cilësisë së veçantë të ekzistencës që e përshkon qenien e saj dhe ka dy aspekte, atë objektiv dhe subjektiv. Aspekti objektiv është fuqia e madhërisë, mahnitëse dhe tmerruese që qëndron në vetë qenësinë e qenies dhe aspekti subjektiv që është nderimi dhe adhurimi nga ana e njeriut përballë kësaj dukurie. Historia e religjionit na thotë se si kjo dukuri shtrihet dhe kuptohet nga popujt e ndryshëm. M. Eliade, duke e vëzhguar të shenjtën gjatë historisë, pohon se "domethënia dhe veprimet e njeriut arkaik nuk ishin të lidhura vetëm nga rendi fizik, por edhe nga një rend transcendent, që e tejkalonte thjesht botën lëndore, rend ky i cili përmes riteve të ndryshme, synonte të përkujtonte aktin e zanafillës të jetës".

Cilësia e të shenjtës pra, është një cilësi transcendentale e ekzistencës, ashtu siç është cilësia e të bukurës dhe e të vërtetës tek qeniet, por siç është thënë, shfaqja e saj bëhet përmes simbolit. Simboli është gjuha e religjionit. Andaj përfytyrimi i shenjtë në religjion nuk mund të bëhet vetëm nga aspekti konceptual, por përmes tregimit që shprehet në mite të ndryshme e që është kallëzimi epifanik i të shenjtës.

"Miti – shkruante M. Eliade – rrëfen një ndodhi të shenjtë, i referohet, ka për hapësirë tregimin mbi Kohën zanafillëse. Në përgjithësi miti synon të përshkruaj ndërhyrjen dramatike të shenjtës apo të mbinatyrshmes në Botë".

ELEMENTET PËRBËRËSE TË RELIGJIONIT

Sipas studiuesve ekzistojnë tri elemente përbërëse të religjionit. Këto elemente janë: miti, riti dhe norma. Duhet shqyrtuar secilin element veç e veç, për të hetuar rolin që luajnë këto tri elemente në fushën e religjionit.

Miti pothuajse përherë është në qendrën e diskutimeve, qoftë në fushën religjioze apo atë filozofike. Në filozofi rrahet problemi i vlerës së mitit, diskutohet pra domethënia poetike e tij. Pyetja që shtrohet nga filozofët rreth mitit është kjo: "A është miti përallë, tregim i imagjinuar apo ndonjë formë e veçantë përmes të cilës shprehet një e vërtetë? Rrymat e ndryshme filozofike siç janë: iluminizmi, racionalizmi, pozitivizmi, mitin e vështron si formë trilluese, e cila nuk disponon me arsyen. Përkufizimet që dalin nga këto rryma, mund të përmbledhen kështu: "Miti është shpirtëzimi i dukurive natyrore të jetës, i cili buron nga njohuria intuitive e njeriut, që e projekton përmes mitit veten e tij, duke i animuar dhe personifikuar të gjitha gjetet e lëvizjes së tij shpirtërore në figura, të cilat janë pjellë e imagjinatës së tij". Mirëpo, sot gjithnjë e më tepër studiuesit e religjionit janë duke hetuar se miti është një gjuhë simbolike, e cila shpreh dhe tregon "ndërhyrjen e të shenjtës në jetë". Së këndejmi, miti nuk e shpreh të shenjtën, por aludon në atë dhe e simbolizon atë.

Në mite e shenjtja vjen e treguar dhe e kallëzuar si objekt i

përkujtimit, ndërsa të qenit është përfshirë nga kjo dukuri. Sikundër që njeriu nuk i mjafton vetëm përkujtimi, por edhe aktualizimi, atëherë është e domosdoshme që përmes ritit të riaktualizohet miti. Miti ilustron ndërhyrjen e të shenjtës në jetë, ndërsa riti e aktualizon këtë ndërhyrje. Mund të thuhet se miti është tregim mbi të shenjtën, ndërsa riti është vepërimit i sjelljes së të shenjtës. Si për mitin, ashtu edhe për ritin, duhet të kemi parasysh gjithë qëllimin e tyre simbolik. Nëse shmanget ky qëllim, atëherë kalohet në antropomorfizëm religjioz, ku riti kalon në bestytni dhe magji, trajta këto deformuese të religjionit. Prandaj në religjion dominon edhe elementi i tretë që përfshihet përmes normës. Secili religjion i ka normat fetare të veta të shprehura në kanon apo libra të shenjtë, të cilat duhet të kihën parasysh përherë për vlerësimin dhe domethënien e tyre.

NATYRA DHE VEÇANTIA E RELIGJIONIT

Për të kuptuar më thellë domethënien e religjionit, është e domosdoshme që ai të vështrohet edhe nga fushat e tjera të njeriut, ku më së shumti spikat veprimtaria e tij, siç janë filozofia, kultura, shkenca, ashtu sikundër do të shohim lidhshmërinë e religjionit me Zbulësen. B. Pascali me të drejtë pohonte se "njerëzit e nënçmojnë religjionin, e urrejnë dhe kanë frikë nga ai, se mos është i vërtetë. Për të shëruar këtë plagë, duhet filluar të dëshmojmë se religjioni nuk është kundër arsyes, se është i denjë për ta ndëruar. Sepse përmes religjionit ne njohim saktësisht se kush është njeriu".

RELIGJIONI DHE FILOZOFA

Një ndër pyetjet më komplekse është pyetja e raportit në mes filozofisë dhe religjionit, mbasi të dyja kanë të bëjnë me shumë gjëra të përbashkëta, siç është Absolutja dhe Transcendencja. Pranë shumë pikëpamjeve të përbashkëta në mes religjionit dhe filozofisë, prapëseprapë dallimi mes tyre është i qartë. Në filozofi Hyji vështrohet si Shkaku i Parë i qenies, ndërsa në religjion Hyji vështrohet si i shenjtë, që do të thotë si burim i shpëtimit. Filozofia gjurmon shkaktin, ndërsa religjioni shpëtimin. Filozofia nisat dhe mbështetet nga arsyeja, ndërsa religjioni nisat dhe mbështetet nga shfaqja e të shenjtës. Në religjion njeriu hyn në komunikim me Hyjin përmes përgjërimit, kultit dhe adhurimit, ndërsa në

Religjioni (1) Mërgimi dikur dhe sot

filozofi hyhet në komunikim me Shkakun e Parë përmes arsyës, vëzhgimit, spekulimit. Në filozofi pra, kërkohet "epifania ontologjike", ndërsa në religjion kërkohet "epifania e të shenjtës".

RELIGJIONI DHE KULTURA

Kur flasim mbi kulturën dhe religjionin, që në fillim duhet të kuptojmë thelbin e kulturës. Shpesh herë me fjalën kulturë nënkuptojmë vetëm edukimin, sjelljet dhe njohuritë që kemi vjelë. Sigurisht se të gjitha këto elemente janë pjesë e kulturës, por nuk janë elementet përbërëse të saj. Elementet arkitektonike të kulturës janë: gjuha, tradita, doket dhe zakonet. Religjioni është pjesë fundamentale e kulturës. Kultura dhe religjioni janë të lidhura njëra me tjetrën si trupi dhe shpirti. Në fakt religjioni është shpirti i kulturës, apo siç shprehet bukur P. Tillich: "Religjioni është substancë e kulturës, ndërsa kultura është trajta e religjionit". Religjioni është burim i pashtershëm i frymëzimit kulturor, si në fushën e artit, letërsisë, muzikës, normave morale dhe shoqërore. Religjioni nuk guxon ta zvetënojë shpirtin e kulturës që shfaqet përmes gjuhës, traditës dhe dokeve të një populli, por nga ato duhet të nisët t'i finisnikërojë dhe t'i lartësojë.

RELIGJIONI DHE SHKENCA

Raporti i religjionit dhe shkencës për shumë kënd duket se janë në kundërshtim dhe në papajtueshmëri. Mirëpo, nëse i vërejmë me kujdes principet e religjionit dhe të shkencës, do t'i hetojmë dallimet e tyre dhe do të vërejmë se kundërthëniet që ngrihen në mes të religjionit dhe shkencës, janë të krijuara nga qëndrimet ideologjike e aksesit nga natyra e njërës apo tjetrës. Objekti i shqyrtimeve të shkencës është bota e dukshme dhe qëllimi i saj është njohja e kësaj strukture se si ajo funksionon. Objekti i religjionit nuk është bota e dukshme, por e shenjtë, e cila shfaqet në ekzistencë. Nëse i mbajmë parasysh objektivat shqyrtuese të njërës dhe tjetrës, atëherë do të respektohen edhe

normat e tyre. Mospërfillja e normave objektive të shkencës dhe religjionit, shkakton përjashtimin mes tyre, siç kishte ndodhur edhe gjatë historisë.

RELIGJIONI DHE ZBULESA

Hyji përveç zbulimit përmes krijesës, njeriut i është zbuluar edhe përmes historisë. Këtu synojmë të vëmë në pah disa qëndrime të mendimtarëve, të cilët kanë lënë gjurmë për sa i përket raportit të religjionit dhe Zbulesës. Njëri prej teologëve më të mëdhenj të shekullit të kaluar, K. Barth, mbante qëndrimin se religjioni dhe Zbulesa qëndruan kundruall njëri-tjetrit papërputhshmëri. Në një kapitull të kryeveprës së tij teologjike *Dogmatica ecclesiale*, K. Barth dallon prerazi religjionin nga Zbulesa. Sipas tij, religjioni është një tentativë e gjykuar të dështojë për të arritur njohjen e Hyjit, mbasi Hyji është Krejt Tjetër. Ai mbante qëndrimin se religjioni është vetëm nxitje e njeriut për të arritur një të vërtetë pa ndihmën e hirit. Ndërsa, mbante qëndrimin se Zbulesa themelohet mbi Fjalën e Hyjit, e cila është zbuluar nga Ai dhe është e vërteta e përvokueshme.

Një qëndrim tjetër që doli nga R. Pannikar, zgjoi jo pak habi në qarqet teologjike. Ky mbante qëndrimin se të gjitha zbulosat burojnë nga Hyji dhe të gjithë themeluesit e religjioneve janë të thirrur nga Hyji. Sipas tij nuk ka ndonjë ndryshim substancial në mes të Mojsiut apo Zaratrutës, në mes të Budës, Jezu Krishtit apo Muhamedit. Në të gjithë është i njëjti Hyj që zbulon het përmes Logosit të Amshueshëm dhe, sipas tij, asnjë emër historik nuk mund të jetë shprehje përfundimtare e Logosit të Amshuar.

Relativizimi i bërë edhe nga njëri edhe nga tjetri autor, janë të paqëndrueshëm, mbasi i pari duke zhvlehtësuar religjionin natyror, i dyti relativizon Personin e Jezu Krishtit si Logos i Amshueshëm i Atit. Religjioni dhe Zbulesa për besimin e krishterë lidhen në Vetën e Jezu Krishtit.

SHKRUAN:

Don Lush GJERGJI

Mërgimi është një dukuri e cila e përcjell njerëzimin gjatë tërë historisë e deri në ditët tona, tani me përmasa biblike të ekzodusit të më se dyqind milion njerëzve, pothuaj gjithnjë në lëvizje, në kërkim të ndonjë vendstrehimi më të sigurt, të punësimit, të për-mirësimit të kushteve jetësore.

Shkaktarët e mërgimit janë të shumëllojshëm: gjendja politike, ekonomike, vërshimet, tërmetet, diktaturat, lufta, thatësia, ndryshimet klimatike, sëmundjet e ndryshme...

Për ne shqiptarët mërgimi është një varrë e kahershme dhe e ditëve tona, qysh prej sundimit turko-otoman dhe të tjerëve: mërgimi i arbëreshëve të Italisë, i arvanitëve në Greqi, i arbanasëve në Turqi, i arbanasëve në Kroaci e kudo gjetiu... e deri më sot: për Kosovën diktatura serbe sidomos gjatë viteve 1981-1999, për Shqipërinë shturja e komunizmit dhe varfëria e skajshme...

Të gjitha këto sfida dhe rreziqe i kemi përballuar vël-lazërisht dhe bashkërisht, me durësë, qëndrësë, strategji paqësore johunore, me bashkëpunim, bamirësi dhe solidaritet të lartë, me ndjenjën e thellë se jemi një si në të mira, ashtu edhe në të vështira.

Mërgimtarët tanë tani gjenden në një gjendje mjaft të vështirë, ndoshta edhe më të ndërlikuar se para apo pas Luftës së vitit 1999, sepse atëherë së paku kishin arsye të jetojnë dhe të punojnë në botën e jashtme, të kontribuojnë në rezistencën tonë paqësore dhe luftarake, ta ndihmojnë njëri-tjetrin për të mbijetuar.

Tani kur fatbardhësisht më nuk ka rezikim jete, diktaturë, dhunë, sundim të të huajve, mërgimtarët tanë disi janë të tronditur dhe të hutuar, me dilema të mëdha në mendje dhe në shpirt: çka të bëjmë tani? Të kthehemi apo të vazhdojmë të jetojmë dhe të punojmë në botën e jashtme? Çka do të ndodhë në të ardhmen me fëmijët tanë, me rininë tonë? A do të kthehen apo do të mbesin gjithnjë jashtë, të huaj, mërgimtarë?

Disa prej tyre edhe do të ktheheshin, por fëmijët dhe rinia e tashme janë "përshtatur" kushteve të jetës dhe të punës

në botën e jashtme. Po ashtu Kosova ende nuk ofron kushte të mira dhe të sigurta për punësim, për investime...

Kjo gjendje shpirtërore krijon një lloj ndarje të brendshme, krijon mosbesim, dyshim, frikë, shqetësim, mërzë, deri diku edhe depresion, mos të them dëshpërim, sepse shumica kanë pritur që pas çlirimit nga diktatura serbe shumëçka do të ndërrohet dhe do të për-mirësohet shpejt dhe mirë, e kjo ka ndodhur vetëm pjesërisht dhe ngadalë...

Dikush prej mërgimtarëve tanë një herë më tha: *A thua për ne shqiptarët ka ndonjë vend të mirë në botë?* Dhe shtoi me mjaft ironi dhe me shumë mallëngjim: *Tani na mbyti pagjumësia dhe malli!*

Disa prej mërgimtarëve tanë janë integruar mjaft mirë në shoqëritë e reja, të tjerët fatkeqësisht ende janë të "tretur" nëpër rrugët e botës, nuk e gjejnë më askund vetveten dhe kështu krijojnë halle për vete dhe për të tjerët.

Shumë dukuri negative të botës së sotme postindustrial, si droga, prostitucioni, alkoolizmi, kriminaliteti i organizuar, terrorizmi, shfrytëzimi i fuqisë së punës, gjejnë "lëndën e parë" edhe te mërgimtarët shqiptarë, sepse është elementi më i brishtë, i pambrojtur dhe shumë i "përdorueshëm" për keq.

Këto të liga tashmë janë të pranishme gati kudo, pra, edhe tek ne dhe ndër ne, e mënyrat për t'u mbrojtur ende janë të pakta dhe të mangëta.

Kish Katolike si Mësues dhe Nënë e besimtarëve ka pasur dhe ka një kujdes të posaçëm ndaj mërgimtarëve. Ud-hëzimi "*Erga migrates caritas Christi*" i Këshillit Papnor për Pastoral të Mërgimtarëve dhe të Udhëtarëve, Vatikan 2004, është një paraqitje e mirë

dhe një sintezë e bukur për bal-lafaqimin e shumë çështjeve të hapura lidhur me mërgimtarët.

Dokumenti ka katër pjesë: Mërgimi, shenjë e kohës dhe kujdesi i Kishës (fq. 11-41), Mërgimi dhe pastoral i pranimit (fq. 42-70), Veprimtarët në pastoralin e bashkësisë (fq. 71-92) dhe Strukturat e dërgimit misionar (fq. 93-99), me 104 numra, me hyrje dhe përfundim si dhe me Rregulloren juridiko-pastorale (fq. 101-116).

Edhe Kisha Katolike në Kosovë, sipas shembullit dhe udhëzimeve të Kishës së përgjithshme, është përpjekur të vihet në shërbim të mërgimtarëve

tanë në Evropë dhe në SHBA, që barinjtë të jenë së bashku me grigjinë e shkapërdërdhur.

Pastorali, liturgia, katekeza, çdo veprimtari baritore ndër mërgimtarët i misionarëve dhe murgeshave shqiptare ka dy shtylla bartëse: fenë dhe kombin, ruajtjen dhe kultivimin e mirëfilltë të trashëgimisë fetare dhe kulturore, ndihmon dukshëm në ruajtjen e identitetit tonë fetar dhe kombëtar, si dhe në procesin e integritetit në rrethe dhe vende të reja.

MISIONET TONA NË BOTË

Kësaj radhe po i përmendim misionet tona katolike në Evropë dhe në Amerikë:

Në Kroaci: Don Ndue BAL-LABANI (Kroaci dhe Sillo-veni)

Në Gjermani: Atë Marjan LORENÇI OFM

Në Austri: Don Izak DODES (Austri dhe Çeki)

Në Zvicër: Don Marjan DEMAJ (Luzern); Don Mikel SOPI (Arau) dhe Don Marjan MARKU (Simnach).

Në Amerikë: Don Anton KÇIRA, Rochester Hills, Detroit; Don Ndue GJERGJI, Beverly-Hills, Detroit dhe Don Pjetër POPAJ në New York.

Bazilika paleokristiane e Stuc dhe ndërhyrjet e Kishës Orto

■ SHKRUAN:

Prof. Dr. Jahja DRANÇOLLI



Pamje e një pjese të Bazilikës nr.1

Komuna aktuale e Istogut ndodhet në pjesën veriperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga 52 fshatra me një sipërfaqe prej 453.84 km katror. Kjo komunë bënë pjesë në verilindje të makroregionit (krahinës etnografike) të Rrafshit të Dukagjinit.

Zona në fjalë, përgjithësisht mbizotërohet nga një relief fushor dhe pjesërisht kodrinor-malor (fusha kapë një lartësi mesatare që luhet nga 350-400 m), me përjashtim të pjesës veriore që përbëhet nga malet e larta (Mokna) me lartësinë e majës më të lartë shkon deri në 2155 m. Këto male bëjnë kufizimin e kësaj komune me Malin e Zi.

Në veri-lindje kufizohet me Komunën e Zubin Potokut (Albanik), në lindje me Komunën e Skenderajt dhe në jugperëndim dhe perëndim me Komunën e Pejës.

Komuna e Istogut lagët nga

lumi i Drinit të Bardhë, lumi i Istogut, lumi i Vrellës dhe procka më të vogla si: Bujena, Gujafci, Sushica, Prroi i Studenicës, etj. Gjithashtu kjo komunë është e njohur për burime të ujërave termale dhe termo-minerale si Baja apo Ilixha e Pejës dhe ajo e Studenicës.

Kushtet e mira klimatike dhe toka mjaft pjellore, që në aspektin pedologjik dhe me vetitë e përshtatshme hidrografike, i plotëson gjitha kushtet e nevojshme për prodhimtari bujqësorë, bëri të mundur zhvillimin e qendrave të banuara që nga Parahistoria. Nuk është e rastit që në këtë zonë janë evidentuar disa qendra arkeologjike me shtrirje kohore që nga periudha e Neolitit e deri në Mesjetën e zhvilluar.

Udhëpërshkruesit e parë të huaj që kanë shkruajtur për disa fshatra të komunës së Istogut ishin anglezi Arthur Evans

(1872-1875) dhe hungarezi Buday Arpad, "*Kërkime arkeologjike në Shqipëri*" (1918). Ndërkaq, kërkimet e para arkeologjike të kryera dekada më parë në vendbanimin e Rakoshit (1966) kanë pasqyruar se fillimet e jetës në këtë mikroregion nisin që në prehistori, apo thënë me saktë u dëshmuar periudha e Neolitit të hershëm dhe të mesëm (kultura e Starçevës), e cila u rikonfirmua edhe gjatë përmjohjes së terrenit gjatë prillit të vitit 2005.

Gërmimet arkeologjike në "Varret e Banjicës" gjatë vitit 1967 ofruan të dhëna për ekzistimin e një qendre të antikitetit të vonë ku dominon zbulimi i një krypte.

Në vitin 1974 në Banjë të Pejës, Muzeu i Kosovës ndërmori një gërmim shpëtimi ku me rastin e hapjes së themeleve të "stacionarit" dolën në dritë gjetje të vlefshme utilitare, armë, përkrenare

dhe stoli të periudhës së hekurit (shek. VI-V para Krishtit). Gërmime tjera pati edhe në tumat e Bajës së Pejës gjatë viteve 1979-80.

Baja e Pejës dhe Bajica duke qënë edhe fizikisht të lidhura ofrojnë një spektër të gjerë të lokacioneve arkeologjike ku praktikisht mendojmë se në bazë të lëndës arkeologjike të zbuluar më parë si dhe nga materiali i evidentur gjatë përmjohjes së vitit 2005, në këto dy qendra duhet të ketë pasur jetë aktive dhe intensive që nga periudha e hekurit, antikitetit e deri në mesjetë për të vazhduar deri në ditët tona.

Konfiguracioni i veçantë natyrorë ka krijuar kushte mjaft të përshtatshme për zhvillimin e komunikacionit që në periudhën romake si pjesë përbërëse të vijës transballkanike Lissus - Naissus me një pozicion të favorshëm, ekzistonin edhe rrugët e rëndësishë së dytë *via vicinale* që lidh-

nin bregdetin Adriatik (Prevalin) me Scupin (Dardanië) siç dëshmonte një trakt i shkurtër rruge midis fshatrave Runik (K. Skenderaj) dhe Rakosh (K. Istog), kjo rrugë që lidhte vendbanimet romake të Mitrovicës së sotme (kjo rrugë vazhdonte për në Municipum DD) me vendbanimet e vogla romake pranë Pejës së sotme. Përreth kësaj rruge (rruga magjistrale Mitrovicë-Pejë përafësisht ndjek këtë vijë) u ngritë sistemi i rrjetit të vendbanimeve që u zhvillua sidomos gjatë periudhës romake, ku disa qendra urbane të përmasave të ndryshme ishin në lidhje të drejtpërdrejtë jo vetëm me rrugët qarkulluese të tregëtisë për kohën por, njëkohësisht shërbenin për lidhje komunikuese me pjesën tjetër të Dardanisë.

Kërkimet rreth lashtësisë së kësaj treve nuk kanë munguar dhe gjatë viteve të fundit.

Studenicë

Studenica gjendet 8-9 km në perëndim të Istogut dhe rreth 20 km. në verilindje të Pejës.

Në vitin 1908 duke punuar në rrënojat e manastirit të Studenicës, një fshatar ka zbuluar një kambanë së bashku me relikte të tjera fetare. Në vitin 1930 janë kryer gërmimet e para (amatoreske) në këtë manastir.

Sipas njoftimeve të prof. R. Grujiq, që më 1908 një fshatar duke gërmuar në rrënoja të manastirit Studenica, ka ndeshur një kambanë së bashku me tekstil. Tekstili është dërguar në Patrikanë të Pejës, ndërkaq kambana është vendosur te françeskanët e Pejës. Në vitin 1930 dy amatorë kureshtarë, kanë kryer gërmime të para në këtë lokalitet, prej nga në vitin e ardhshëm është bërë raporti i shkurtër. Raporti i parë profesional për rrënojat e Studenicës (pa gërmim), si dhe foto-t, i botuan arkitekti Gj. Boshkoviq dhe ing. Sergije Smirnov më 1936, pasi që në vend kishin bërë studimin e rrënojave të këtij monumenti të kultit paleokristian. Gërmime sistematike janë bërë më 1966-1970. Pas gërmimit janë kryer konservime të domosdoshme. Sipas gërmimeve janë arritur një sërë rezultate. Është dëshmuar se kompleks i mesjetar i manastirit,

lenicës dokse Serbe

si seli e peshkopit të Hvosnës pas pushtimeve nemanjide dhe pas vendosjes së organizmit kishtar ortodoks serb në këto anë (pas vitit 1219), është ndërhyrë mbi një ndërtim të tërësishëm kulturor paleokristian të shek. IV-VI dhe të rindërtimeve të saja gjatë mesjetës së hershme (deri në shek. XI). Nga fundi i shek. XIV, përkatësisht nga vitit 1381 kjo seli peshkopale u ngritë në mitropoli të kishës ortodokse serbe. Kisha kryesore e manastirit, njënefëshe, është një ndërhyrje pas vitit 1219, mbi bazilikën paleokristiane trinefëshe dhe kishte një absidë altari të madh, nga jashtë katrore, nga brenda gjysmërrethore, më pastaj kishte transeptin e këndimit, traveun e shkurtër perëndimor dhe narteksin e gjerë. Pjesa e mesme e naosit është ngritur me kube. Më vonë, në të dy pjesët anësor janë ngritur nga një kullë, në përdhese të tyre gjendet kapela. Ndërkaq, në pjesën perëndimore i është mbështetur ekskonarteksi. Në jug dhe veri prej absidës i shtohen pastoforët. Kisha është murosuar me sigë të gdhendur nga mjeshtër të trojeve bregdetare romano-arbërore. Këtej, edhe ndërhyrjet e kryera këtu janë nën ndikimin e romanikës bregdetare, kjo që vërhet, sidomos në aplikimin e këndeve të drejta për absida, si dhe në radhitjen e lezeneve këndore, që ndanin ballinat (fasadat).

për shumë njerëz, si dhe qeramika e antikitetit të vonë. Nga pjesët e tjera ndërtuese të manastirit është zbuluar trepezaria dhe konaqet, të vendosura në veri prej kishë. Në qendër është vendosur cisterna. Shihen gjurmët të murit mbajtës të manastirit, sidomos në pjesën veriore dhe themelet e një kulle katrore, ku ndoshta ishte e vendosur dera kryesore. Çdo gjë tjetër është e shkatërruar.

Gjetjet tjera në Studenicë:

Fragment i pllakës mbivarrore, lartësia: 0, 27 m, gjërsia: 0, 27 m, trashësia: 0, 27 m, gjendet e murosuar në xhaminë e fshatit Studenicë.



M. Ul[p(ius)...]
Dec(urio) m(unicipii)
Aedi[is...]

Fragment i pllakës mbivarrore, e zbuluar në rrënojat e kompleksit kishtarë të Studenicës.




Max-
[imi] na uxo(r)
[ma]rito

Dëmtimet në bazilikën paleokristiane të Studenicës

Ekipi i Institutit Arkeologjik të Kosovës gjatë përmohjeve arkeologjike në fshatin Studenicë, përveç rikonfirmimeve të mëparshme (nga viti 2003) të kompleksit kishtarë të kësaj qendre ndeshi në dëmtime të reja që siç vërehet janë shkakuar nga popullata lokale. Mëqë, kemi njoftime shkencore paraprake për këtë monument të kultit, sugjerojmë fuqimisht që të ndërmerren masa restauruese dhe konservuese si dhe të vihen nën mbrojtje nga organet kompetente.

“ Kisha kryesore e manastirit, njënefëshe, është një ndërhyrje pas vitit 1219, mbi bazilikën paleokristiane trinefëshe dhe kishte një absidë altari të madh, nga jashtë katrore, nga brenda gjysmërrethore, më pastaj kishte transeptin e këndimit, traveun e shkurtër perëndimor dhe narteksin e gjerë. Pjesa e mesme e naosit është ngritur me kube. Më vonë, në të dy pjesët anësor janë ngritur nga një kullë, në përdhese të tyre gjendet kapela. Ndërkaq, në pjesën perëndimore i është mbështetur ekskonarteksi. Në jug dhe veri prej absidës i shtohen pastoforët. Kisha është murosuar me sigë të gdhendur nga mjeshtër të trojeve bregdetare romano-arbërore. Këtej, edhe ndërhyrjet e kryera këtu janë nën ndikimin e romanikës bregdetare, kjo që vërhet, sidomos në aplikimin e këndeve të drejta për absida, si dhe në radhitjen e lezeneve këndore, që ndanin ballinat (fasadat). ”



■ Bazilika Paleokristiane ■ Rindërtime paleokristiane
▨ Ndërhyrje pas vitit 1219 □ Ndërhyrje pas vitit 1219



Pamje e një pjese të Bazilikës nr.2



Lurdi – vend i lajmërimit të Zojës Mari

■ SHKRUAN:
Don Marjan MARKU

Qyteti i Lurdit

Lurdi është një ndër shenjtëroret më të vizituara në botë. Qyteti shtrihet buzë Pyrenejeve, qëndron 420 metra mbi det dhe gjendet në jugperëndim të Francës, afër kufirit me Spanjën. Qyteti sot ka diku rreth 19.000 banorë dhe përmes lumit Gave ndahet në dy pjesë: në pjesën e sipërme të qytetit, ku shtrihet qyteti i vjetër dhe kështjella dhe në pjesën e poshtme të qytetit, ku shtrihet shenjtërorja dhe hotelet për shtegtarë. Pas Parisit, sipas të dhënave komunale, Lurdi është qyteti më i vizituar në Francë, ku në vit bujnë diku rreth 6 milionë shtegtarë.

Shën Bernadeta

Shën Bernadeta ka lindur më 7 janar 1844 nga prindërit François Soubirous dhe Louise Soubirous e L. Casterot. Ishte një familje e varfër, ndërsa Bernadeta gati tërë jetën ishte e sëmurë nga murtaja, astma dhe tuberkuloza e eshtrave.

Prej datës 11 shkurt 1858 e deri

më 16 korrik 1858, Bernadeta ka përjetuar 18 lajmërimet të Zonjës. Në përgjithësi, Zonja lutej së bashku me Bernadeten, nganjëherë bisedonte me të, e udhëzonte dhe e lajmëron për detyrën e angazhimit të Kishës në Lurd. Më 15 korrik 1860 Shën Bernadeta sëmurët rëndë nga astma dhe kështu përfundon në spital, këtu qëndron deri në vitin 1866, kur dhe shkon për t'u bërë motër rregulltare në Nevers.

Më 30 tetor 1867 Shën Bernadeta pranon kushtet e përjetshme në kuvendin e Shën Gildard në Nevers. Të gjitha motrat fitojnë nga një detyrë, ndërsa Bernadeta për shkak të shëndetit të saj të dobët, nuk fitoi kurrfarë detyre. Ajo u detyrua të përkujdeset për të sëmurët dhe të ndihmonte në kuzhinë.

Më 28 mars 1878 Shën Bernadeta përsëri sëmurët rëndë. Përherë e ndiente vetën keq e më keq. Një herë kishte thënë: "Përherë shërohem, kur e marr sakramentin e vajimit. Ky sakrament është një mjet i mirë për shërim". Më 16 prill 1879, mjekët propozuan që të ulet në një karrige për t'ia lehtësuar frymëmarr-

rjen, dhe në atë karrige vdiq në ora 15.00, në moshën 35-vjeçare.

Bernadeta gjatë tërë jetës së saj ka shkruar vetëm një letër. Ndër të tjera, në këtë letër shkruan edhe këtë: "Me ndëgjue do me thënë me dashë. Me vuetë në beshtje për Jezusin, do me thënë me dashë. Me dashë në realitet, do me thënë me dhënë gjithëka, gjithashtu dhe me vuetë".

Në festën e zonjës së papërluter të vitit 1933, papa Pius XI e ka shpallur Bernadeten shenjtëreshë. Gjatë hulumtimeve për shenjtërim, trupi i Shën Bernadetes ishte i paprishur edhe pse për 30 vite pandërpre kishte qëndruar në varr. Edhe sot mund të shihet trupi i Shën Bernadetes i paprishur dhe ruhet në një sarkofag nga bronzi dhe kristali në kishën rregulltare të Shën Gildardit në Nevers.

Lajmërimet në Lurd

Lajmërimi i parë ishte më 11 shkurt 1858.

Ishte ditë e enjte, rreth orës 11:00 para dite. Përjashta ishte një mjegull e dendur, një kohë tipike në Lurd. Në dhomën ku jetonin, cila më parë ishte një burg (Cachot), mungonin dru për ngrohje. Bernadeta me motrën e saj Antoinette dhe me shoqen e saj Jeanne Abadie kishin shkruar tek shpella Massabielle (tek shkëmbi), për të mbledhur degë të drunjtve. Bernadeta pohon: "Unë dëgjova një frushkullim... Çova sytë në drejtim të shpellës dhe pashe një zonjë të veshur me petka të bardha. Ajo kishte një petk të bardhë, një shami të bardhë, një rrip të kaltër dhe në të dy këmbët nga një trëndafil të verdhë. Po ashtu dhe rruzarja ishte e verdhë. Zonja mori rruzaren në dorë dhe bëri kryq. Po ashtu dhe unë bëra kryq. Rashë në gjunjë dhe së bashku

“Unë dëgjova një frushkullim... Çova sytë në drejtim të shpellës dhe pashe një zonjë të veshur me petka të bardha. Ajo kishte një petk të bardhë, një shami të bardhë, një rrip të kaltër dhe në të dy këmbët nga një trëndafil të verdhë. Po ashtu dhe rruzarja ishte e verdhë. Zonja mori rruzaren në dorë dhe bëri kryq. Po ashtu dhe unë bëra kryq. Rashë në gjunjë dhe së bashku me zonjën luta rruzaren.”

me zonjën luta rruzaren”.

Ky lajmërim i Zonjës e bëri Lurdin të njohur në gjithë botën.

Lajmërimi i tretë ishte më 18 shkurt 1858, një javë më vonë.

Gjatë këtij lajmërimi, Zonja foli për të parën herë me Bernadeten. Sipas propozimit të përcjellësve të Bernadetes, ajo kishte marrë një fletë dhe një persë në dorë dhe i kishte thënë Zonjës, nëse dëshiron diç të thotë, që atë ta shkruajë në letër. Në këtë Zonja i kishte përgjigjur: "Çka dëshiroj të them nuk është e nevojshme të shkruhet. A ke gëzim, që gjatë 15 ditëve të vish këtu. Nuk ju premtoj se do t'iu bëjë të lumtur në këtë jetë, por në jetën tjetër".

Lajmërimi i shtatë ishte më 23 shkurt 1858.

Ky lajmërim ishte në orët e mëngjesit dhe ka zgjatur një orë. Bernadeta tregon se gjatë këtij lajmërimi, Zonja ia kishte treguar tri fshetësi, për të cilat nuk guxon të flasë me askënd. Me Bernadeten kishin ardhur rreth 100 njerëz. Me të ishte dhe avokati Dufo, pjesëtar i kështillit komunal dhe më vonë kryetar i Lurdit, Mons. Estrade dhe mjeku Dr. Dozous, hulumtues i ngjarjes i cili ishte ateist. Ata kishin ardhur për ta përcjellë për së afërmi Bernadeten dhe për ta hulumtuar rastin e Lurdit. Ky mjek, edhe pse ishte ateist, më vonë u pagëzua dhe u bë dëshmitar i ndodhivë të Lurdit.

Lajmërimi i tetë ishte më 24 shkurt 1858.


Ishte të pranishëm 200 – 300 njerëz. Zonja i kishte thënë Bernadetes: "Pendesë, pendesë, pendesë! Lutni Hyjin për mëkatat!" Pastaj Zonja e ka lutur Bernadeten që të ecën e gjunjëzuar deri tek shpella, dhe që ta puthë tokën në shenjë pendese për mëkatat.

Lajmërimi i trembëdhjetë ishte më 2 mars 1858.

Ishte të pranishmit rreth 1600 persona. Zonja ka kërkuar prej Bernadetes që t'ju thotë meshtarëve që aty ta ndërtojnë një kapelë dhe që të organizojnë një procesion: "Zonja më tha që të shkoj tek meshtarët dhe t'ju them që në atë vend ta ndërtojnë një kapelë. Unë shkova tek famullitari për t'ia sjellë këtë lajm. Ai më shikoi për një moment dhe pastaj më tha me një zë të ngritur: Si quhet ajo Zonjë? Unë i përgjigja se nuk e di. Ai më tha, dubet ta pyesësh. Ditën e ardhshme e pyeta, por ajo vetëm buzëqeshi me mua".

Lajmërimi i gjashtëmbëdhjetë ishte më 25 mars 1858.

Ishte rreth orës 5 në mëngjes. Bernadeta përsëri e pyeti Zonjën për emrin e saj. Tri herë ajo e tha emrin, por ajo nuk mund ta mbante mend emrin e saj. "Ajo i drejtoi sytë e saj kah qielli, i bashkoi duart e veta në gjoks dhe më tha: UNË JAM ZONJA E PAPËRLUTER. Ato ishin fjalët e fundit që m'i tha Zonja. Ajo i kishte sytë e kaltër". Bernadeta duke vrapur, u ngut shpejt për të shkruar tek famullitari, për t'i treguar për emrin e saj, ishte krejtësisht e lumtur.



Trupi i paprishur i Shën Bernadetes në Nevers

Lajmërimi i shtatëmbëdhjetë ishte më 7 prill 1858.

Në këtë takim ishin të pranishëm 100 persona dhe lajmërimi ishte rreth orës 5 në mëngjes. Në këtë lajmërim ishte i pranishëm dhe mjeku Dr. Dozous. Në këtë lajmërim ka ndodhur dhe mrekullia e qiriut. Bernadeta mbante dorën e saj 10 – 15 minuta në flakë të qiriut, flaka depëronte nëpër gishtërinjtë e saj duke mos i djegur fare. Mjeku që e hulumtonte rastin, menjëherë vrapoi tek Bernadeta për ta analizuar dorën e saj, por ajo fare nuk ishte djegur. Nga ky rast dhe ky mjek u kthye në fe, u pagëzua dhe tha kështu: *"Unë jam i bindur se ky rast është një fenomen misterioz dhe mbinatyror".*

Mrekullitë në Lurd

Me këtë vend janë të lidhura dhe dy gjëra tipike që e përbëjnë Lurdin e këto janë uji i Lurdit dhe mrekullitë.

Uji në shpellë ka filluar të burojë gjatë lajmërimit të nëntë, më 25 shkurt 1858, sipas porosisë së Zonjës. Bernadeta tregon: *"Zonja më tha, që të pi ujë nga burimi. Unë nuk pashe burim dhe u nisa në drejtim të lumit Du Gave. Ajo më tha, që mos të pijë nga lumi, por më tregoi me gisht që të shkoj nën shkëmb. Unë shkova dhe gjeta vetëm pak ujë me baltë. Unë e mora në dorë, por nuk kisha në dorë ujë, por vetëm baltë. Pastaj fillova të gropoj me gishtërinjtë dhe kështu arrita deri tek uji. Tri herë e guajta, sepse ishte shumë i ndotur. Të katërtën herë arrita të pi".* Ky burim, prej kësaj dite e deri më sot buron pa ndërprerje. Uji e këtij burimit është një shenjë e pastiritimit të brendshëm dhe për këtë arsye Zonja ka dashur që të burojë ky ujë. Në aspektin e analizave, ky ujë është siç çdo ujë tjetër, por dallon nga ujërat tjera, sepse

është i vetmi ujë në botë i cili nuk prishet.

Kur flasim për Lurdin, pa tjetër duhet të flasim dhe për mrekullitë. Mrekullia është një shenjë e Hyjit, shenjë se Hyji është në veprim. Në Lurd ndodhin shërime të mrekullueshme, të cilat nuk mund të shpjegohen në aspektin mjekësor. Për këtë qëllim në vitin 1882 është themeluar një zyre e mjekëve në Lurd. Kjo zyre është e hapur për të gjithë mjekët, nga e gjithë bota, pa marrë parasysh prej nga vinë dhe çfarë feje i takojnë. Kjo zyre ka për detyrë që nga aspekti mjekësor t'i analizojë rastet e shërimeve dhe t'i shpjegojë mundësitë e aspektit medicinal. Që nga viti 1947 ekziston dhe një zyre tjetër në Paris, e cila përbëhet nga 30 mjekë. Nëse ndodh ndonjë shërim, atëherë në radhë të parë do të analizohet gjendja shëndetësore e të shëruarit. Nëse rasti në aspektin mjekësor shpjegohet si i pashpjegueshëm, atëherë përmes zyrës "Medical grande guerison" dëshmohej një gjë e tillë. Një vit më vonë rastin e merr "Comite Medical International" dhe ia dorëzon një specialisti. Pas kontrollimit të tij rasti paraqitet në mbledhjen e përgjithshme të këshillit, e cila mbahet vetëm një herë në vit në Paris dhe ata vendosin për shërimin, a mund të shpjegohet në mënyrë të natyrshme apo jo.

Pastaj gjitha këto akte të analizave ia dorëzojnë ipeshkvit të dioqezës prej nga vjen i shëruari. Ipeshkvi formon një komisioni i cili dhe një herë do ta analizojë rastin dhe pastaj merret vendimi, a është shërimi një mrekulli apo jo.

Prej vitit 1858 e deri më sot, mjekët kanë shpallur mbi 6000 raste të shërimeve, si raste të pashpjeguara në aspektin mjekësor,

por prej tyre Kisha ka shpallur vetëm 64 raste si mrekulli.


Shtegtimi i mërgimtarëve shqiptarë në Lurd

Shqiptarët katolikë në mërgim kanë filluar të shtegtojnë në Lurd në vitin 2000. Në këtë vit kanë shtegtuar vetëm besimtarët katolikë nga Gjermania. Një vit më vonë filluan shtegtimet dhe nga Zvicra dhe kështu vit pas viti, numri i shtegtarëve është rritur, sa që në këtë vit (prej 16. 05. 2007 deri 20. 05. 2007) ishin të pranishëm më se 600 shtegtarë shqiptarë, shumica e të cilëve ishin nga Zvicra, por ishte dhe një autobus nga Gjermania. Shtegtimin e sivjetshëm dhe më madhështor e bëri dhe prania e shkëlqesë së tij, Imzot Dodë Gjergji. Po ashtu ishin 10 meshtarë dhe 9 motra të nderit.

Në Lurd për çdo ditë kremtuam meshën shenjte në gjuhën shqipe, po ashtu patëm dhe udhën e kryqit, e cila është tipike në Lurd. Morëm pjesë në procesionin me të shenjtërueshmin sakrament dhe në procesionin e dritave. Procesioni me të shenjtërueshmin sakrament është një thirrje e Krishtit, që së bashku me të, të ecim nëpër rrugët e vështira të botës. Në procesionin e dritave, të gjithë besimtarët bartnin nga një qiri të ndezur në dorë. Procesioni është një rrugë e dritës dhe e fesë. Ajo ka për qëllim që besimtarët t'i përkujtojnë në pagëzimin e tyre: në Krishtin, dritën e botës, që të shkojmë pas tij dhe të gjithë si vëllezër dhe motra, të cilët besojnë njëjtë, të cilët kanë të njëjtën shpresë dhe të njëjtën dashuri, të ecin në drejtim kah Ati. Krishti thotë: Unë jam drita e botës, kush vjen pas meje do të jetojë përgjithmonë.



Burimi i ujit mbrekullihës.



Shpella e lajmërimit të Zojës



Misionet Katolike në Evropë LOURDES 2007



Imzot Zef Simonin

Intervista me monsinjor Zef Simonin, ipeshkëv ndihmës i Shkodrës

Shqipëria nuk është shtet mysliman

Para bisedës me monsinjor Zef Simonin, ipeshkëv ndihmës i Arqipeshkvisë së Shkodrës, pimë nga një kafe "tarnake". Kështu e quanin shkodranët e vjetër kafën e punuar në shtëpi, e emri i kishte mbetur nga një familje fisnike shkodran, e cila i gostiste mysafirët me një kafe të mirë

Na tregoni diçka për jetën tuaj.

Imzot Zef Simonin: Jam lindur më 1 dhjetor 1928 në Shkodër, nga prindërit Kolë Simon Moni dhe Gjyste Mihill Ugashi, babai shkodran i vjetër, me traditë mbi 400 e sa vjet në Shkodër. Është kënaqësi kur flas për prindërit: ishin shembullorë. Familjen e kisha një familje besimtare, ishin shumë të devotshëm, nga aty kemi dalë dy vëllezër meshtarë, unë dhe Gjergji. Shkollën fillore e kam kryer në shkollën fillore të përmendur "Skenderbeg" në Shkodër. Ishte një shkollë e mrekullueshme. Të gjithë profesorët kishin mbaruar studimet në Vjenë, në Romë e gjetiu nëpër Evropë. Drejtor ishte Pjetër

Troshani, pas tij vjen Zef Pali, një intelektual i madh i Shkodrës.

Liceun e kam vazhduar në liceun françeskan. Shkolla françeskane ka qenë model me profesorë shumë të shquar. Në atë kohë vepronin tre lice këtu: ai françeskan, liceu jezuit dhe gjimnazi i shtetit. Në atë kohë Shkodra ishte qendër e intelektualëve të Shqipërisë. Në vitin 1946 ishim në klasën e shtatë kur u mbyll liceu françeskan, i vranë profesorët si atë Gjon Shllakun, që ishte nxënës i filozofit të madh francez Zhan Zhak Mariten e të tjerë. Profesor që, kur pati ardhur në Shkodër, shndriste mbarë Shqipëria. Ishte një mjerim kur na mbyllën shkollën. Ishte trish-

tim i madh, se ne nxënësit e pamë të pushkatuar atë Gjonin, profesorin tonë të nderuar. Çfarë tmerrri, çka kanë bërë komunistët në ne... Pastaj vazhduam shkollimin në liceun shtetëror, aty na kanë trajtuar me dashamirësi. Pas përfundimit të shkollimit punova si mësues këtu në qytetin e Shkodrës. Autor i 16 veprave.

AHMET ZOGU ISHTE TINËZAR

Na thuni diçka më shumë për jetën në Shkodër dhe më gjerë në Shqipëri nën qeverinë e Zogut!

Imzot Zef Simonin: Në fillim të them, katolikët nuk e kanë pëlqyer qeverinë e Zogut, ai ishte tinëzar, donte të shkonte mirë me klerin tonë, si Fishta, Pal Dodaj etj. Por kishte shumë të atillë që ai i ka persekutuar dhe i ka përndjekë. Ai hidhte gurin e fshehte dorën. Ai e pushkatoi Dom Gjon Gazullin. E vari në litar, pa asnjë faj, duke e akuzuar

se ishte prijës i një kryengritje kundër tij në Malësi, e ai nuk ishte... Populli ende shkon te varri i tij, aty luten. Kur u gjykua për vdekje dom Gjoni, shpejt ka ndërhyrë kleri, në veçanti disa meshtarë që ishin pro qeverisë së Zogut. Shkuan e biseduan direkt me Zogun që mos ta bëjë një gjë të tillë, mos ta varte një klerik pa pikën e fajit. Zogu u kishte premtuar se nuk do të ndodhë një gjë e tillë, por ditën e nesërme u gjet i varur dom Gjoni. Dhe nga ajo ditë të gjithë ata meshtarë që ishin pro qeverisë së tij u larguan, sepse kuptuan se Zogu nuk ishte ai që pretendonte të shfaqej në opinion, ishte krejt ndryshe.

Në përgjithësi qyteti ynë kishte një kulturë në atë kohë,

“...katolikët nuk e kanë pëlqyer qeverinë e Zogut, ai ishte tinëzar, donte të shkonte mirë me klerin tonë, si Fishta, Pal Dodaj etj. Por kishte shumë të atillë që ai i ka persekutuar dhe i ka përndjekë. Ai hidhte gurin e fshehte dorën. Ai e pushkatoi Dom Gjon Gazullin. E vari në litar, pa asnjë faj, duke e akuzuar se ishte prijës i një kryengritje kundër tij në Malësi, e ai nuk ishte.”

të mbrojtur në çdo fushë nën qeverinë e Zogut.

Kisha dhe kleri në atë kohë ishin shumë të përgatitur. Kisha kishte një independencë nga shteti dhe bënte punën e vet, nuk pengohej edhe aq prej qeverisë. Ishin atë Fishta, atë Ambroz Marlaskaj, atë Anton Harapi, ipeshkëvi Vinçenc Prennushi e

shumë të tjerë, të gjithë mirë të përgatitur, me shkollë të mbaruar jashtë.

Në vitin 1945 vjen komunizmi. Cili ka qenë pretexti për salvimin dhe persekutimin e Kishës?

Imzot Zef Simoni: Komunizmi ka hyrë më 29 nëntor 1944, ishte edhe dhjetori afër, nata e Kërshëndellave. Dom Mikel Koliqi ishte famullitar në katedrale. Ai nuk donte ta bënte festën e natës së Kërshëndellave për shkak se kishte frikë të ndodhte ndonjë e papritur, sepse aty ishin komunistët. Atëherë vetë kanë ardhur komunistët te monsinjor Thaqi, një njeri shumë i zoti, kërkojnë prej tij të festohet. Monsinjor Gaspër Thaqi i thotë se në nuk e kishim lajmëruar popullin se do të ketë meshë, ne do t'i lajmërojmë, i përgjigjen komunistët. Kanë dalë derë më derë i kanë thirrur njerëzit në meshë. Kisha katedrale u mbush përplot atë natë. Por nuk shkoi shumë dhe e arrestuan dom Ndre Zadejen, kapën dom Lazër Shantojen, i pushkatuan. Të dy janë në listën e martirëve të kishës. Dom Lazërit ia preni duet e kambë e pastaj e pushkatuan. Për dom Ndrën u bë një vaj i madh në Shkodër në Ditën e Larit. Kur Mehmet Shehu, që ishte kapo, person numër dy pas Enver Hoxhës, për mos me thënë edhe i pari, kur ka shkruar në arqipeshkvi për urime për ditën e Pashkëve, vetëm dom Tomë Lasku, sekretari i tij, por arqipeshkvi nuk e ka pritë. E kështu në dhjetor të '45-sësh kanë filluar prapë arrestimet, së pari e arrestuan jezuitin Daniel Dajani e pastaj të tjerët. I pështynin në gjyq, oh, kanë bërë namin në ta. Mund t'i lexoni në librin e atër Zef Pllumbit "Rrno vetëm për me tregue" në librin e atër Konrad Gjolajt "Çinarët": e shumë të tjerë kanë shkruar për këto gjëra. Shteti ishte i mbyllur hermetikisht, por ne gjenin kanalet tona të lajmërojmë së paku

“Gjatë 15 vjetëve të mia në burg isha shumë entuziast, shumë i vendosur, por për çudi një vjet pa dalë prej burgut, më përshkon një ide e ateizmit. Me të gjitha ato përgatitje shkollore e teologjike, prapë më erdhi kjo ide, se Zoti nuk ekziston. Ishte një moment trishtimi, të jetosh pa Zot. Por shpejt i thashë vetit, a e di ti çka mendon tani? Dhe e hoqa atë tundim që më kishte ardhur në kokë. Thashë, o Zot më fal”

Vatikanin për të gjitha këto që ngjanin këtu. Unë në atë kohë nuk isha prift, por isha shumë i afër me kishën e në veçanti më vonë me monsinjor Çobën. Këto lidhje i mbante kryesisht përmes ambasadeve, e në veçanti përmes ambasadës italiane në Tiranë. Këto edhe ishin shkak kryesor që unë u dënova me burg, sepse nuk e kam denoncuar ipeshkvin për raportet e tija. Ishte kjo një e drejtë e jona, nuk ishte diçka kundër shtetit. Dhe herën e dytë u dënova rishtas për shkak të shkrimeve të mia. Kisha disa vepra të botuara e kryesisht flisja për dhunën që bëhej në mënyrë sistematike ndaj popullit të pafajshëm.

Si ka qenë jeta në burg?

Imzot Zef Simoni: Isha në burgun e Spaqit, burgu më i vështirë që ka pasur Shqipëria. Kishte edhe shumë meshtarë të tjerë aty, të gjithë kishim të njëjtin fat, punonim nëpër miniera. Puna ishte shumë e rëndë. Kur kam shkruar për këtë, kam vënë në dukje se 104 persona kanë vdekur në minierë. Aty nuk kishim asnjë shpresë, na dukej se çdo gjë kishte marrë fund. Vetëm duhej të jesh i fortë moralisht, e i tillë ishte vëllai im dom Gjergji. Na thoshte: mos u mërzmni se do të dalim... Për meshtarët ishte edhe më rëndë... Unë jam shuguruar fshehtas më 1961, fshehtas nga monsinjor Çoba, në dhomën e tij së bashku me Dom Kolec Tonin, por komunistët e kishin marrë vesh këtë gjë, dhe për këtë mundimi në burg ishte edhe më i rëndë.

Kishte djem të fortë aty, s'kishin hallin që bënin burgun. Kishte të dënur aty që kishin kaluar krejt rininë e tyre. Ishte një mysliman aty, i lodhur, i prishur, i erdhi koha me dalë prej burgut. Ky thoshte: "Unë po lirohem, por ku kam me shkue", s'kishte ku të shkonte. Kishte hy në burg 18 vjeç, dilte 52 vjeç prej burgut. I këputur krejt. Shpresa prapë na mbante, uzdajën nuk e kemi bjerë. Gjatë 15 vjetëve të mia në burg isha shumë entuziast, shumë i vendosur, por për çudi një vjet pa dalë prej burgut, më përshkon një ide e ateizmit. Me të gjitha ato përgatitje shkollore e teologjike, prapë më erdhi kjo ide, se Zoti nuk ekziston. Ishte një moment trishtimi, të jetosh pa Zot. Por shpejt i thashë vetit, a e di ti çka mendon tani? Dhe e hoqa atë tundim që më kishte ardhur në kokë. Thashë, o Zot më fal... Kishte në burg shumë priftërinj, shumica ishin të rinj, askund nuk shihej një dritë, se prapë do të jetojmë jetën tonë si meshtarë, por çati asnjë prej tyre nuk e ka braktisur thirrjen e vet e me u martue, nga qindra e qindra meshtarë, nuk e di a janë dy apo tre raste.

Shteti komunist kishte shtyrë me dhunë Kishën të pranojë një "Kushtetutë të Kishës Katolike" në atë kohë.

Imzot Zef Simoni: Ishte kushtetutë e dhunshme, dhe në vete mbante shumë mungesa. Ishte ky një dhunim i të drejtave të Kishës. Me këtë formë shteti kërkonte t'i skllavëronte

meshtarët që të bëhen të tyre. Me këtë kushtetutë nëse duhej një djale të shugurohej për prift, duhej bërë lutja organeve shtetërore. Rast i tillë isha edhe unë, kur monsinjor Çoba e bëri kërkesën që unë të bëhem meshtar, përgjigjja nuk erdhi kurrë. Monsinjori ishte i sëmurë, e tha se ka frikë se mund të ndodhë ndonjë e papritur e na thirrri neve e na shuguroi në dhomën e vet, ashtu fshehtas. Kështu në këtë mënyrë ka shuguruar shtatë vetë. Kështu shkoi deri më 1967, kur definitivisht i mbyllën kishat.

Nuk i mbylli kishat rinia, por shteti komunist

Ramiz Alia thotë se rinia i ka mbyllur kishat.

Imzot Zef Simoni: Ramiz Alia është një njeri që s'e ka shoqin për të keq, pra shumë i keq, i pa shoq. Si bëhet një punë e tillë pa ditur krejt i shtetit, ata shumë mirë i kanë ditur ato gjëra, ata vetë i kanë nxitur të bëjnë një punë kaq të poshtë. Të ishte burrë, duhet të thotë se unë e kam bërë atë, e jo t'i lihet faji rinisë kot. Patër Pjetër Meshkalla, një meshtar idealist, më thoshte: Enver Hoxha nuk ka llogari për të keqën. Ai të gjitha ato të zeza i bën e s'qan kryet për atë punë. Është një njeri i keq. Çka do të thotë kjo, është e keqja në të, është vetë e keqja. Për Mehmet Shehun më thoshte ka qenë i keq, por ka pasur një farë burmie, ndërsa gruaja e Enverit ishte kulmi i të keqes. Komunist të mirë nuk ka pasur, sepse idenë kryesore e kanë pasur ateizmin, zhdukjen e fesë, por fenë ata e kanë ndaluar, por s'kanë mundur ta zhdukin.

Por sot kisha prapë gjallëron, edhe pse kemi mungesë të madhe të meshtarëve, ajo vazhdon rrugën e vet të shenjtë. Janë bërë mjaft ndërtime, por ka nevojë ende për personel kishar që të

mbulohen të gjitha skajet e Shqipërisë.

Bushi gabon kur thotë se Shqipëria është shtet islam

Na thoni edhe diçka për vizitën e Xhorxh Bushit në Shqipëri.

Imzot Zef Simoni: Po, vizita e tij ishte një dhuratë e mirë bërë Shqipërisë. Populli shqiptar e priti jashtëzakonisht mirë. Populli shqiptar është një popull me merita, merita të hershme. Por ka edhe të metat e veta, si p.sh. islamizimi, e islamizimi nuk e lenë të ecë përpara. Vetë fakti se në qeverinë tonë ka shumë pak njerëz katolikë, aty tregon se diçka nuk është në rregull. Në këto troje ka edhe shenja të fundamentalizmit, por ne i mbyllim sytë para këtij fakti, por një e besoj se nuk do të ketë përplasje të natyrës së tillë këtu. Edhe pse presidenti Bush e quan Shqipërinë vend mysliman, ky vend nuk është mysliman, ishte një vlerësim i gabuar i presidentit Bush. Kjo nuk është e vërtetë. Shqipëria është një vend katër besimesh. Shumica janë myslimanë, por me një diferencë shumë të vogël. Fjalët si "Shqipëria islame e priti Bushin..." etj. janë shprehje të gabuara. Shqipëria është e katër besimeve. Kjo është e saktë. As Kosova nuk është islame, ka edhe të tjerë atje. Është e vërtetë që shumica e madhe janë myslimanë, por Kosova nuk është shtet mysliman. E në veçanti në Shqipëri nuk mund të thuhet, presidenti Bush i harron ortodoksët që janë shumë, por edhe katolikët që nuk janë pak. Por vizita e presidentit Bush në përgjithësi ishte shumë pozitive për popullin shqiptar, e në veçanti për Kosovën, sepse fjala e tij është garanci për shtetësinë dhe pavarësinë e saj.

Intervistoi:
Patër Ndue Kajtazi, OFM

“Edhe pse presidenti Bush e quan Shqipërinë vend mysliman, ky vend nuk është mysliman, ishte një vlerësim i gabuar i presidentit Bush. Kjo nuk është e vërtetë. Shqipëria është një vend katër besimesh. Shumica janë myslimanë, por me një diferencë shumë të vogël. Fjalët si” Shqipëria islame e priti Bushin... etj. janë shprehje të gabuara. Shqipëria është e katër besimeve. Kjo është e saktë. As Kosova nuk është islame, ka edhe të tjerë atje. Është e vërtetë që shumica e madhe janë myslimanë, por Kosova nuk është shtet mysliman.”



Pamje e qytetit të Shkodrës

Shqyrtimi i kartës ekumenike

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

Pikënisja e ekumenizmit është vetëdija personale, familjare dhe kishtare e të gjithë të krishterëve, se ndarjet dhe përçarjet e ndryshme shekullore dhe aktuale janë pasojë e mëkatit, por mund të jenë edhe burimi i pasurisë dhe begatisë nëpërmjet traditave të llojllojshme të krishtera.

Nga ky këndvështrim bashkimi i të krishterëve nuk është më *uniformizëm*, por pasuri e ndërsjellët nëpërmjet dialogut ekumenik që për qëllim ka arrijten e bashkimit të plotë në dallime, ku dallimet më s'do të ishin shkas apo rast i ndarjeve dhe përçarjeve kishtare.

Ky shpirt i ri ekumenik është fryti i Trinitë së Shenjtes, sepse vetëm nën udhëheqjen e Shpirtit Shenjt të krishterët pranojnë dhe dëshmojnë fenë e përbashkët në Jezu Krishtin, të dërguarin e Atit, Shëlbuesin e mbarë njerëzimit.

Thelbi apo bërthama ekumenike është kjo: *Për ne të krishterët Ungjilli i Jezu Krishtit është shpirti dhe zemra e çdo tentimi dhe kërkimi ekumenik.*

Kjo domethënë se lutja dhe puna e përbashkët ka për qëllim që të dëshmojmë se të gjithë jemi nxënësit e Jezu Krishtit në botën e sotme, "që të gjithë të jenë një. Sikurse ti, Atë, që je në mua dhe unë në ty, ashtu edhe ata të jenë një në ne, që ta kuptojë bota se ti më dërgove" (Gjn 17, 21).

1. VETË ZOTI KËRKON DHE FTON NË BASHKIM

Ky bashkim është i veçantë në fë, shpresë dhe dashuri, si shenjat më bindëse të bashkësisë së krishterë para botës: "Nëse e doni njëri-tjetrit, të gjithë do t'ju njohin se jeni nxënësit e mi" (Gjn 13, 35).

Konkretisht: pranimi i dallimeve dhe kërkimi i pasurive në dallime, si dhe kërkimi i bashkëpunimit për çështjet e përbashkëta evropiane dhe botërore si paqja, drejtësia, dialogu ndërfaqetarak, varfëria, çarmatimi, ekologjia... janë detyra dhe mundësi për të krishterët.

2. DUHET TAKUAR NJËRI-TJETRIN

Ekumenizmi ungjillor kërkon prej të gjitha kishave të krishtera së pari ripërtëritjen e zemrës në

kuptimin biblik, gatishmërinë për pendim, pendesë dhe hapje, bashkëpunimin burimor dhe në vazhdimësi me Zotin dhe me të afërmin. Vetëm kështu do të

është rast i madh dhe i mirë që të krishterët të marrim qëndrime të përbashkëta rreth çështjeve jetësore siç janë vlera dhe rëndësia dhe shenjtëria

e jetës, pranimi dhe kultivimi i saj në të gjitha fazat, prej zanafillës, ngjizjes e deri te kalimi në amshim, liria dhe dinjiteti njerëzor, puna, siguria, shëndetësia, bioetika... dhe iniciativat e përbashkëta rreth ungjillëzimit të ri dhe promovimit të njeriut.

3. URATA E PËRBASHKËT – ZEMRA E EKUMENIZMIT

Urata e përbashkët dhe nevoja për njëri-tjetrit për bashkimin e Kishës së Jezu Krishtit është fryt dhe dhuratë e Zotit dhe e historisë.

Konkretisht: kjo na mëson ta çmojmë pasurinë liturgjike të kishave të krishtera, të grupeve biblike dhe meditative dhe të këshillave të përbashkëta ekumenike dhe liturgjike për përgatitjen e takimeve, lutjeve dhe kremtimeve ekumenike, ndërfaqetare.

4. DËSHMIA E PËRBASHKËT E FESË SË KRISHTERË

Evropa gjendet para dukurive të shekullarizimit, indiferentizmit dhe ateizmit praktik, para materializmit, konsumizmit dhe hedonizmit të shfrenuar, dhe kjo gjë kërkon që të gjithë të krishterët ta dëshmojnë fenë e krishterë si parakusht për ringjallëzimin e konti-

nitit të vjetër, dhe më gjerë, të botës mbarë.

Konkretisht: nisje të përbashkëta ekumenike për ungjillëzimin dhe përkrahjen e njëri-tjetrit në këto veprimtari, sepse dialogu, ekumenizmi nuk është më vetëm çështje e disave, shqyrtim etik apo moral, por nevojë dhe domosdoshmëri fetare dhe kishtare për të gjithë.


5. DIALOGU EKUMENIK – E VETMJA ALTERNATIVE

Si të krishterë, nxënësit e Jezu Krishtit, jemi të ftuar dhe të dërguar që të jetojmë dhe të veprojmë vëllazërisht dhe bashkërisht, sepse vetëm kështu mund ta dëshmojmë fenë tonë të përbashkët, që është themel shumë më i rëndësishëm se dallimet teologjike, liturgjike, morale, etike...

Konkretisht: vetëm duke u nisur nga kjo dhuratë e madhe, feja në Jezu Krishtin, Shëlbuesin tonë, mund ta kërkojmë dhe ta gjejmë bashkimin e plotë në Të dhe me njëri-tjetrit. Bashkimi në fë doemos domethënë edhe bashkimi në dashuri, themeli dhe kulmi i çdo bashkimi. Atëherë do të angazhohemi për thellimin dhe kultivimin e kulturës së dialogut ndërkishtar, si kusht apo parakusht edhe për dialogun ndërfaqetarak.

6. SHËRBIMI I EKUMIZMIT PËR EVROPËN E BASHKUAR

Jezusi thotë: "Lum pajtuesit sepse do të quben bijtë e Hyjit" (Mt 5, 9). Këtë rol konkret dhe botor duhet ta kenë të gjithë të krishterët, si ekumenizmi i dashurisë dhe shërbimit, për një kontribut më



pakësohen dhe shlyhen pasojat e mëkatit, që ka shkaktuar ndarje dhe përçarje, urrejtje dhe luftëra vëllavrasëse.

Pa pajtim mes të krishterëve të Evropës, vështirë se mund të arrihet, pritët apo projekttohet pajtimi i popujve të saj.

Konkretisht: përvuajtërisht dhe vërtetën sipas shpirtit ungjillor të dashurisë, duke kërkuar falje njëri prej tjetrit si bashkësi-kisha dhe si individë, të krishterë. Kështu do të kemi mundësi të luftojmë me sukses kundër paragjykimëve dhe ndjenjës së vetëmjaftueshmërisë, duke njohur dhe pranuar pasuritë shpirtërore në traditat e ndryshme të krishtera për begatim të ndërsjellët.

Në një atmosferë të tillë kërkojmë rastet e volitshme për ta takuar njëri-tjetrit për t'u dëshmuar se jemi nxënësit e Jezusit, dhuratën më të madhe të fesë së krishterë. Ekumenizmi



Të rinjtë e religjioneve të ndryshme për një botë të bashkuar

cilësore dhe përmbajtësor për paqe, bashkim dhe luftë kundër varfërisë, moszhvillimit dhe keqpërdorimeve të ndryshme të njeriut.

Konkretisht: angazhimi për paqe dhe pajtim mes popujve lypset të jetë më konkret dhe më i fuqishëm, si p. sh. në ish-Jugosllavi, në Ballkan, në Irlandë, në Spanjë... Themeli i këtij bashkëpunimi është struktura e kishave të Evropës: KEK-u (Konferenca e Kishave të Evropës) dhe CCEE (Këshilli i Konferencave Ipeshkvore të Evropës).

7. TË KRISHTERËT – SHPIRTI I EVROPËS

Kishat e krishtera janë të gjitha për bashkimin e Evropës, por ky bashkim nuk mund të jetë vetëm ekonomik dhe politik, si është tani, por edhe shpirtëror, kulturor dhe fetar.

Konkretisht: feja e krishterë aftëson qytetarët e Evropës për pranimin e dallimeve etnike, fetare, kulturore, gjuhësore, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë të çdo populli dhe feje, ku s'do të ketë më të privilegjuar dhe të diskriminuar, por çdo çështje e hapur do të zgjidhet me marrëveshje dhe me dialog.

8. PAJTIMI I POPUJVE, FEVE DHE KULTURAVE TË NDRYSHME DHE RUAJTJA E AMBIENTIT

Evropa e Bashkuar është shprehja historike e popujve, feve dhe kulturave të ndryshme, që së bashku janë begatuar dhe huazuar, kuptohet, për mozaikun e sotshëm dhe të mirën e përbashkët të të gjithëve.

Konkretisht: çdo njeri është shëmbëlltira e Zotit dhe si i tillë duhet të trajtohet si në Kishë ashtu edhe në shoqëri, nëpër shtete dhe vende të ndryshme. Kjo detyrë parësore kërkon prej të gjithëve luftën kundër nacionalizmave të tepëruar, për mbrojtjen e pakicave dhe të mërgimtarëve, sidomos të grave dhe të

fëmijëve, si dhe mbrojtjen e ambientit, si shtëpia e përbashkët e mbarë njerëzimit – ekologjia.

9. PËRFORCIMI I BASHKIMIT TË VEÇANTË ME POPULLIN HEBRË

Vetëm ndjenja e përkatesisë së përbashkët biblike e të krishterëve dhe e Popullit të Zgjedhur, hebrejve, si historia e shëlbimit, por edhe si aktualitet, zbulimi i rrënjëve të përbashkëta i të gjitha kishave të krishtera me hebraizmin, mund të ndihmojë dukshëm në përmirësimin e marrëdhënieve krishtere-hebreje. Historia e përgjakshme e përndjekjeve ndaj hebrejve lypset jo vetëm dënuar nga të gjithë, por duhet kërkuar falje dhe mësuar nga e kaluara.

Konkretisht: Evitimi i çdo paragjykimi biblik apo historik ndaj hebrejve, pranimi i fajëve dhe pendimi, dënimi dhe luftimi i përbashkët kundër urrejtjes dhe formave të ndryshme të antisemitizmit dhe lutja e përbashkët për marrëdhënie sa më të mira për të tashmen dhe ardhmen tonë të përbashkët.

10. DIALOGU ME FETË TJERA

Evropa për shkak të mërgimeve të vazhdueshme gjithnjë e më tepër është pluraliste kombëtarisht dhe fetarisht. Kjo është sfida dhe mundësia e re për Evropën, sidomos me praninë e myslimanëve, të cilët më parë pak ishin të pranishëm në Evropë. Pa dialogun ndërkishtar – ekumenik është mjaft vështirë dialogu ndërfetar krishtero-mysliman.

Konkretisht: Të jesh vetvetja është e drejta themelore e të gjithëve, por edhe parakusht për t'u lejuar dhe mundësuar edhe të tjerëve që të jenë vetvetja, identiteti evropian, që nënkupton edhe luftimin e paragjykimeve antislamike.

Koncili i Dytë i Vatikanit na porositi qartë: "S'ka ekumenizëm



Papa Benedikti XVI dhe Bartolomeo II

pa kthim të dyfishtë, kah Zoti dhe kah njeriu, ndërsa kardinali Walter Kasper ka thënë kështu: "S'ka ekumenizëm pa falje dhe pa pajtim".

Karta Ekumenike është një dokument mjaft i mirë, por nuk guxon të mbetet vetëm dokument, por duhet shndërruar në porosi jete, në jetë me Zotin dhe me të afërmin.

Nënshkrimi kremtor i këtij Dokumenti u bë në Strasburg më 22 prill 2001 nga ana e metropolit Jeremie, President i KEK-t dhe kardinal Miroslav VLK, President i CCEE-së.

Para nesh është jeta dhe mundësitë e llojllojshme të dialogut ekumenik. Kjo ka rëndësi të posaçme edhe për të krishterët shqiptarë katoliko-ortodoks, që përgatit dhe begaton edhe dialogun krishtero-mysliman.

Patriku ekumenik Atenagora I thoshte kështu: "Dialogu do të sqaronte shumë gjëra. Unë jam gjithnjë i gatshëm për dialog..."



Aleksii II,
Patriku i Moskës

Takimi Benedikti XVI – Patriku Aleksii II gjatë vitit 2007-2008?

Sipas deklaratave të kardinal Walter Kasper, President i Këshillit Papnor për Promovim e Bashkim të të Krishterëve, takimi mes papës Benedikti XVI dhe Patrikut të Moskës dhe të tërë Rusisë Alkesii II do të ketë mundësi të ndodhë gjatë vitit 2007-2008.

Këtë lajm e ka vërtetuar edhe arqipeshkvi dhe Primasi i Qipros Chrysostosi II gjatë takimeve të shumta që pati në Romë prej 4 deri në 6 qershor 2007. Ai ndër të tjera tha: "Papa është i gatshëm dhe Aleksii II është i hapur... Pa dyshim duhet përgatitur këtë ngjarje që të jetë e suksesshme..." (ZENIT.org).



Kthimi i Dritës

Promovimi i revistës fetare – kulturore Drita dhe monografisë së Mons. Nikollë Mini në Teatrin Kombëtar në Prishtinë



Pas një kohe të gjatë të pushimit të revistës sonë Drita, më tepër se një dekadë, ajo përsëri kthehet për ta vazhduar jetën e saj në kultivimin e vlerave të shkrimit shqip dhe për të qenë një pishtar i kohës. Për ta shënuar këtë ngjarje, Ipeshkvia e Kosovës si botuese e revistës, organizoi promovimin e saj më 25 maj 2007 në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, dhe bashkë me "Dritën" edhe monografinë e Pjetër Pergjokës dhe Don Tomë Karrisës për "Mons. Nikollë Mini. Nderim dhe falënderim", që ishte ideatori dhe kryeredaktori i parë si saj.

Në mesin e të ftuarve të shumtë dhe miqve të Kishës sonë dhe dashamirëve të fjalës së shkruar, e të përcjellë nga media jonë e Kosovës, u shpalos fenomeni DRITA, nga fillimi i saj e deri në ditët tona kur ajo e rifilloi jetën.

Moderatori i promovimit ishte shkrimtari dhe poeti Sarë Gjergji. Në fillim fjala iu dha ipeshkvit Imzot Dodë Gjergjit, i cili në cilësinë e Bariut të Kosovës i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen në këtë datë të shënuar për shtypin tonë katolik në Kosovë. Për revistën Drita në përgjithësi foli shkrim-

tari dhe kritiku prof. Prend Buzhala, i cili bëri një paraqitje të shkëlqyer të gjithë asaj që sot mund ta quajmë Fenomeni DRITA.

Një histori të shkurtër të shtypi katolik në Kosovë e paraqiti Don Lush Gjergji, i cili edhe e bëri promovimin e librit "Mons. Nikollë Mini. Nderim dhe falënderim." Promovimi u shoqërua me një pikë muzikore, nga Akademia e Muzikës. Fare në fund, për atë rast të gjithë të pranishmëve revista u nda falas dhe u shtrua një kokete për të mysafirë, ku ishte rasti i takimit dhe shkëmbimit të urimeve mes të pranishmëve.

Fjala përshëndetëse e Ipeshkvit me rastin e promovimit të revistës "DRITA"

Fort të dashur miq,

Shprehja e ndjenjës së brendshme, mendimit individual apo të përbashkët, dëshira për të shpalosur mundësitë apo nevojat njeriun për të gjetur mënyra komunikimi të ndërsjellë. Kjo përpjekje njerëzore për të komunikuar ndër vete, gjatë periudhave të ndryshme historike ka pasur ndryshime që nga ai komunikim i hershëm me gjepte, mandej me fjalë, e deri të komunikimi me shkrim.

Kisha, familja e Zotit në tokë, ka pasur gjithmonë nevojë të komunikojë me anëtarë të vet po edhe me shoqërinë njerëzore. Ndaj e konsideron "të drejtë të vetenë natyrore" të përdorë mjetet e komunikimit masiv, për të bartë tek të gjithë personat porosinë e mirë Ungjillore, dhe



për të marrë pjesë aktive në historinë njerëzore.

Është bërë e ditur për të gjithë që Kisha ka përdorë shkrimin e letrave dhe librave për të ushtruar misionin e vet. Tani ato

shkrime kanë mbetur pasuri e pagmueshme e kulturës së mendimit shqip, shkrimit në shqip dhe komunikimit shqip me të kaluarën tonë. Gjatë angazhimit për të shpallur Lajmin e mirë të Ungjillit, Kisha Katolike në trojet tona, asnjëherë nuk është përpjekur, për ta zhveshur njeriun shqiptar nga vlerat njerëzore, traditë, kulturore, kombëtare, por me një kujdes të veçantë është munduar t'i përtërijë, t'i kultivojë, t'i mbrojë dhe t'i dhurojë ato gjeneratave të reja.

Revista Drita, e më vonë edhe Shtëpia Botuese "Drita", që nga viti 1970 e deri më sot ka qenë dhe ka mbetur shpalëse e fuqishme e Lajmit të mirë të Ungjillit, po edhe kultivuese e zellsime e vlerave morale, shoqërore e kombëtare. Nëpërmjet "Dritës", çdokush ka pasur mundësi të shohë, se si është i

mundshëm gërshtimi i misionit të "Shpalljes së Fjalës" me misionin e kultivimit të pasurive kombëtare dhe dinjitetit njerëzor në përgjithësi.

Dikur komunikimi ishte i kufizuar! Sot, komunikimi audioviziv po edhe ai i shkruar, është zhvilluar deri në atë masë, për t'u bërë i kapshëm për të gjithë njerëzit.

Prandaj, ndikimi dhe rëndësia e mjeteve të komunikimit është rritur në atë masë sa që pa to, çdo përpjekje mbetet e mbyllur në geton e mendimit të kufizuar të personave apo grupeve. Madje, në aspektin politik, ekonomik dhe shoqëror mediat janë bërë përcaktuese të suksesit dhe mjet i fuqishëm i ndikimit.

Promovimi i sotëm i Dritës, në asnjë mënyrë s'duhet kuptuar si përpjekje e Kishës për t'u futur në garë me mediat e tjera apo

për t'i konkurrar ato, sepse ajo është një zonjë e moçme, e cila është rinue dhe shfaq dëshirën:

të bashkëbisedojë me të tjerët, për fenë-religjionin, për shoqërinë, për kulturën, për politikën, për të kaluarën dhe për të ardhmen tonë të përbashkët, të cilën duhet ta ndërtojmë krah për krah.

Për çdo lexues gazete ofrojmë "Dritën", sepse ajo do të bëjë dritë për të lexuar Gazeta, në të vërtetë "Drita" shkon me çdo gazetë.

Në fund ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj dhe ju ftojme për bashkëpunim.

Prishtinë, Teatri Kombëtar,
25 maj 2007

+Dodë Gjergji,
ipeshkvi i Juaj

Shtypi katolik shqiptar në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore

Drita – Ishte ky zëri ynë, dëshmi e qartë e pranisë dhe veprimtarisë sonë, e lashtësisë dhe traditës shekullore, me një dëshirë të vetme, që Kisha jonë të dëshmohej në shërbim besnik dhe flijues ndaj Zotit dhe Popullit.

■ SHKRUAN: Don Lush GJERGJI

Shtypi katolik shqiptar në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore pasqyron dhe dëshmon gjendjen mjaft të vështirë të Kishës sonë dhe të krishterimit. Ishte kjo një periudhë e heshtjes dhe e territ, pa ndonjë mundësi të gjallërimit të shtypit, por edhe të jetës fetare dhe kulturore, anësimi dhe anatemimi i traditës dhe kulturës sonë të lashtë të krishterë. Asotëherë në Kosovë ndjehej mungesa e madhe e klerit katolik shqiptar, si dhe varfëria e skajshme, përndjekja sistematike, mbi të gjitha mungesa e lirisë fetare dhe kombëtare.

Kleri ynë ishte i vyeshëm dhe i kalisur në vuajtje, i vetëdijshëm për këtë gjendje mjaft të vështirë

dhe të rrezikshme, për këtë vdekje dhe agoni në heshtje; si gjithmonë, edhe kësaj here, nuk dorëzohej para rrebesheve dhe dredhive komunisto-ateiste, të cilat, herë haptazi, herë tinëzisht, kërkonin me ngulm dhe me urëjtje heshtjen dhe rrënimin e elementit tonë më të çmuar dhe më të lashtë iliro-shqiptar dhe katolik.

Kështu në vitin 1962 filloi botimi i fletushkës "ZANI I ZOJËS CERNAGORE", disa numra në ciklostil, më vonë disa edhe në shtyp, nën udhëheqjen e Don Nikollë Minut, famullitarit të Prizrenit.

Ishte ky zëri i parë botor, dëshmi e qartë e pranisë dhe e veprimtarisë sonë, e lashtësisë dhe traditës shekullore, me një dëshirë të vetme, që Kisha jonë

të dëshmohej në shërbim besnik dhe flijues ndaj Zotit dhe Popullit.

Me emërimin e ipeshkvit shqiptar Imzot Nikë Prela (1918-1996) në mbarim të vitit 1969, filloi edhe botimi i revistës fetare-kulturore DRITA, për Pashkët e vitit 1970, pikërisht më 25 mars të këtij viti. Dhe prapë në skenë ishte Don Nikollë MINI, si drejtor përgjegjës i Dritës.

Historiku i DRITËS është pasqyrimi i pësimeve dhe përndjekjeve të Kishës Katolike në Kosovë, me "shpërngulje" të dhunshme: 1970-1974 botohet në Prizren, së pari si organ i Zyres famullitare të Prizrenit. Drejtor përgjegjës ishte Mons. Nikollë Mini, kryeredaktor Don Damjan Kurti, famulliatr i Velezhës. Në vitin 1974 redaksia kaloi prej Prizrenit në Ferizaj dhe drejtor përgjegjës ishte Imzot Nikë Prela, kryeredaktor prapë don Damjan Kurti.

Prej vitit 1978-1981 botohej në

Sarajevë, sepse në Kosovë nuk kishte mundësi dhe hapësira për botimet fetare katolike. Dritën e udhëhoqi praktikisht Don Lush Gjergji dhe botohej nëpërmjet Qendrës Misionare në Sarajevë në shtypshkronjën "Oslobodjenje".

Dhe "shpërngulja" vazhdon: në Zagreb 1981-1983, drejtor përgjegjës ishte prapë Imzot Nikë Prela, kryeredaktor Atë Hil Kabashi; 1984-1990 në Zagreb dhe kryeredaktor prapë ishte Don Lush Gjergji. Gjatë viteve 1990-1991 kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës ishte prapë Imzot Nikë Prela, me shtyp në Prishtinë.

Gjatë vitit 1997 dolën disa numra me format të ri dhe kryeredaktorë Don Mikel Sopi dhe Don Robert Kola.

Përse u ndërpre botimi i revistës fetare-kulturore DRITA?

Për shkaqe politike: Serbia kërkonte që revista jonë të regjistrohej në Beograd, e jo

më në Kosovë. Ipeshkvi ynë i atëherëshëm Imzot Nikë Prela, së bashku me redaksinë, si dhe me miq dhe bashkëpunëtorë, vendosi që Drita mos të botohej përkohësisht si revistë, por të përforcohej si shtëpi botuese katolike për ne, për Shqipërinë dhe diasporën shqiptare në mbarë botën.

Deri më tani shtëpia botuese Drita ka botuar mbi 70 tituj të ndryshëm, dhjetë biblioteka apo seri, ndër të cilët vend të spikatur ka botimi i BIBLËS, në 35.000 kopje, Shujta shpirtërore mbi 100.000 kopje. Parimi kryesor ishte dhe mbetet VERITAS IN CARITATE, E Vërteta Në Dashuri.

Le ta vlerësojë së pari Zoti, pastaj edhe Populli, punën, veprimtarinë, pra ninë, dëshminë dhe "sofrën" vëllazërore që e ka shtruar Kisha jonë në këto periudha mjaft të ndërlikuara dhe me plotë rreziqe. (Verzioni i shkurtër, vër. red.)

Fjala që nuk mund të mbërthehej në pranga

■ SHKRUAN:
Prend BUZHALA

Të ndëruar pjesëmarrës,

Para publikut të sotëm rikthehet edhe njëherë, tashmë e rilindur, e përkohshmeja "Drita" e dikurshme që doli prej vitit 1970 e këndej. Fjalët ringjallje, ringritje, rilindje, i shkojnë përshkati jo vetëm krishterimit, po edhe popullit tonë, të ringjallur e të rilindur. Janë fjalë që lindin nga rrënjët e civilizimit evropian. Nëse ky civilizim është ngritur mbi antikën greko-romake, mbi krishterimin dhe mbi epokën moderne të Renesancës e të Humanizmit, që shënojnë modelin e identitetit evropian të popujve të kësaj hapësire, pikërisht atëherë kur dolën dhe mediat e para; atëherë "Drita" ka arsyetani ta përjetojë ringjalljen e saj, ka të drejtë ta kremtojë dhe promovojë të kaluarën e saj.

"Drita": Katekizëm atdhetarie, kulture e besimi, liturgji shpresëdhënëse

Mirëfilli, të gjithë e kemi ndier se sa vlerë ka Fjala e Shkruar, e publikuar, me bukurinë, qartësinë, mesazhin a domethënien kuptimplote të saj. Fjala e tillë, e shkruar dhe e përjetuar edhe të "Drita", a nuk ishte jo vetëm dëshmi e së dëshmes, po edhe urë që lidh të dëshmen me të sotmen? Dikush ka thënë: bëhet ndërldhëse në mes çastit të dhënë dhe amshimit. Kishte të drejtë Umberto Eko, kur thoshte se asnjë fjalë në librin e tij „Emri i trëndafilut“ nuk është e tija. Ai do ta ketë ndër forcën krijuese të Fjalës së Hyjit, sepse e ka kuptuar, që edhe mbas vdekjes së autorit, degjohet Fjala e Përshtetshme dhe aty gjendet Bashkëbiseduesi që jeton përjetësisht në mes nesh. Prandaj meshat e shenja gjithnjë i shoqëron leximi i Fjalës së Hyjit. Kështu ishte edhe me themeluesit e jo pak autorë të "Dritës" që nuk janë më në mes nesh, si Mons. Nikollë Mini, ipeshkvijtë Nikë Prela, Mark Sopi e shumë meshtarë e autorë të tjerë të penës; porse shkrimet e tyre dhe porositë e tyre të Fjalës së Hyjit, jetojnë ndër ne.

Po sot, çka mund të thotë „Drita“ kur na rrethojnë kaq e kaq gazeta, kaq e kaq revista, kaq e kaq media të shkruara e elektronike; kur jemi të zënë nga rrjeta e universit të pafund të internetit dhe nga bota e teknologjisë moderne informative? Ajo vetëm mund ta vazhdojë misionin e saj të dikurshëm për kujdesin ndaj Fjalës së Shkruar, të Fjalës së Matur kundruall Fjalës që vret tjetrin për tërë jetën, që poshtëron a që le vragë në zemër. Nuk ka tjetër mision, pos atij të para tri dekadash, që tjetrit t'i jepet e drejta të mendojë ndryshe, të veprojë ndryshe, të ndiejë ndryshe, të kuvendojë ndryshe,

ashtu sikundër këtë e kishte bërë gjatë viteve '70 e këndej kundruall Një Mendimi, Një gazete, Një Radiotelevizioni, Një Partie, pra kundruall monizmit të jetës shoqërore, ashtu sikundër "Drita" këtë mund ta bëjë sot me fjalën e urtë e të mençur kundruall furive e dallgëve të fjalëve të zbrazëta e që nuk thonë asgjë. "Drita" vetëm se do të dijë ta dëshmojë më mirë se ne të tjerët identitetin tonë, të na rreshtojë ndershmë e përsëritshëm aty ku e kemi vendin: në gjirin e popujve të civilizuar të Evropës e në Grigjen e Hyjit.

E kuptojmë se sot secili kërkim të flasë, secili kërkim ta ketë të drejtën e fjalës, po pak kush prej të gjithë këtyre ka se çka të thotë: për ta pasur, në radhë të parë, vullnetin për informacion të plotë, për ta përballuar, në radhë të dytë, heshtjen e shenjtë të medimit, dhe për t'u identifikuar me hallat e preokupimet e tjetrit a për të hyrë në lëkurën e tjetrit, në radhë të tretë.

gjithçka, po e traumatizonte shoqërinë për ta çuar në kaos e përleshje të përgjakshme; "Drita" shërbente si një Katekizëm atdhetarie, katekizëm kulture e besimi, si liturgji shpresëdhënëse e kasnec i ditëve të tjera që do të vinin sipas vizionit për një shoqëri demokratike e evropërdimore; ishte, pra, një katalizator i të menduarit ndryshe. Dhe historia e koha i dhanë të drejtë kësaj reviste. Në kohën kur po propagandoheshin profetë të rremë të kësaj politike ditore, kur po propagandohej lumturia e barazja komuniste; "Drita" kishte të tjera ambicie, krejt modeste, dëshirën e ambicien për të ndriçuar rrugët me shembullin e Fjalës e të jetës së këtyre misionarëve dhe me Fjalën e jetën e tyre bënin që t'i jepnin jetës sonë më shumë kuptim... Ishte kohë kur edhe një libër, gazetë, revistë, institucion, personalitet, autor, politik, zyrtar a gazetar e gjithçka tjetër e maste veten me

që dënon dashurinë e vajzës e të djalit sikundër e shpallte këtë patriarkalizmi ynë oriental, se duhej të përmyse mendimi i huaj antikombëtar e antinjerëzor që thotë se mashkullit i lejohet gjithçka e femrës asgjë, se femra u dashka të mbetet e mbuluar, se nuk u dashka të shkollohej, se duhej vetëm të lindte fëmijë, apo si na fyenin armiqët e që ua bënim edhe ne qejfin, "të jetë makinë për lindje" etj. etj. Dhe kleri, në këtë mision, në krye me organin e saj "Dritën", dolën fitimtarë.

Traditën e tolerancës ndërftare shqiptare, të predikimit se të krishterë e myslimanë janë vllazën, e ka krijuar kleri i krishterë shqiptar

Por "Drita" si para tri dekadash, ashtu edhe sot, mban qëndrimin kritik ndaj fenomeneve të shfaqura e të çoroditura edhe të botës moderne, sikundër janë droga, prostitucioni, alkoolizmi apo dukuritë tjera të shëmtuara. Dhe për aq e aq dekada ajo solli emra të anatemuar aty, shkrime e veptra të mohuara, kur të tjerët iknin nga këto shkrime e nga këta emra të bekuar si prej

e të besimit fetar. "Drita", si dije, edhe sot vjen për të na ligjëruar me gjuhë të kuptueshme, për ta përcjellë mesazhin e Hyjit, për ta ngritur, ringritur e ringjallur pa ndërprerje bashkësinë e njerëzve vullnetmirë, simpantin reciproke, miqësinë si tek apostujt. Këtë traditë të tolerancës ndërftare shqiptare, të predikimit se të krishterë e myslimanë janë vllazën, e ka krijuar pikërisht kleri i krishterë shqiptar si filozofi të veten kombëtare, e ka predikuar gjithnjë që nga kohët e Buzukut e të Budit, ani se armiqët e deklarorin dhe e bënin të kundërtën. Dhe „Drita“ pati ndjekur traditën e autorëve të hershëm të Letërsisë së Vjetër Shqipe, posi të Pjetër Budi, i cili që më 1621 shkruante: „Dhe jo vetëm të krishterët, por edhe të parët e myslimanëve... Të gjithë duan të dalin nga herë e mirë prej kësaj gjendjeje të mjeruar ose të vdesin me armë në dorë.“

Drita ishte kronikë reale e kohës; ajo nuk ndiqte modelin e pamjes së gjenjshërtë... ashtu si e thurnin për veten tyre këtë pamje mashtruese të kronikës së kohës mediat e regjimit. Janë të njohura fjalët e Marshall McLuhan-it „Medie do të thotë mesazh.“ Kurse „Drita“ ishte edhe porosi, edhe medie e së vërtetës.

Dhe në këtë kronikë nderi, besimi e humanizmi, autorët e kësaj të përkohshmeje, nuk kanë se për çka të turpërohen, sepse edhe sot, pas kaq dekadash, ata do ta nënshkruanin secilin shkrim me emrin e vet, si dikur, dhe sepse ato shkrime i kanë qëndruar kohës; ndryshe nga gazetaret e regjimit që nuk mund të mburreshin me nënshkrimet e tyre të dikurshme pranë artikujve a shkrimeve të tyre jo të pakta me porosi a ideologjike aq edhe johumane, kundërnjerëzore, sa kundërfetare aq edhe kundërkombëtare. Ashtu shtrëngoheshin të shkruanin për të mbijetuar kalemshinjtë e regjimit! I kuptojmë deri diku! Porse, të mos harrohet: kishte edhe një tribunë tjetër që mendonte ndryshe, sikundër ishte "Drita"; kurse në ilegalen atdhetare të Kosovës gjallëronte shtypi ilegal i rezistencës kundër shtypjes, për ta mbajtur në këmbë mospajtimin nacional kundruall shtypjes së Kosovës.

Pse të mos e themi: "Drita" ishte si ajo Fjala e Hyjit që nuk mund të mbërthehej në pranga. Dikur apostujt prangoseshin, po Fjala e Hyjit nuk prangosej. Mund të vritej ndonjë misionar besimi a të burgosje, si ka nodhur aq shpesh në hapësirat shqiptare, por jo edhe Fjala e Hyjit, ashtu sikundër edhe "Drita" kundruall kohëve të rënda të komunizmit e kundruall aq e aq vështirësive të kohës, po e shpallte pandërprerë mesazhin e krishterë. Edhe sot, secili prej nesh le ta ketë parasysh këtë mësim të shekujve: Fjala e Hyjit nuk mund të prangosej!



Ideologjinë Sunduese komuniste: me Shpërbli-min politik, me Medaljen politike, me Mirënjohjen politike, me Karrierën politike, sepse gjithçka ishte shndërruar në politikë shtypëse; veçse ishte një shtyp tjetër, do autorë të tjerë, që nuk mateshin me këso shpërbli-mesh e medaljesh as nuk pritin këso mirënjohesh. Ishte thjesht "Drita" kjo, një gazetë e pashpërblyer, me autorë që sulmoheshin, shaheshin e fyheshin barbarisht, që akuzoheshin si agentë të Vatikani, të perëndimit a të SHBA-ve, por që shpërbli-min a mirënjohjen e merrnin prej Njeriut të thjeshtë, Njeriut besimtar, dhe, gjithsesi, këtë e merrnin edhe prej Historisë që po u jepte e iu dha të drejtë. Ishte koha kur "Drita" shpallte hapur se duhej të ndodhte emancipimi kombëtar, se duhej të ndihmojmë në barazinë e femrës me mashkullin, se duhej të përmyse mendimi kundërnjerëzor

zjarrit; ndër-kohë që ky zjarr të frymëzonte thellësisht; dhe për aq e aq dekada "Drita" përcolli nëpër të kremtet e mëdha të krishtera porositë e Hyjit, mesazhin për vlerat esenciale të besimit e të humanizmit. Dhe për deri sa ishte kohë, kur karrierat politike, shpërbli-met politike a mirënjohjet e tilla ngriheshin mbi fatkeqësinë e të tjerëve, mbi mijëra burgosje politike të të tjerëve për drejtësi kombëtare, për Republikën e Kosovës a për pavarësi; "Drita" nuk kishte dhënë asnjëherë shenja solidarizimi me politikën e tillë shtypëse të regjimit. Madje, madje, që nga numrat e parë, ajo botohej në standardin e gjuhës letrare shqipe dhe janë mjaft artikuj që shfaqnin këtë solidaritet kombëtar me atdheun amë, Shqipërinë, ani se andej po ndodhte një shtypje tjetër e egër kundër vëllezërve të besimit e të gjakut dhe kundër lirisë së fjalës

Drita e Dritës rrezaton me dizajn të ri

Ishte viti 1970, kur më ra në dorë numri i parë i gazetës fetare, kulturore e Kishës Katolike me emrin Drita, nën përgatitjen e Don Nikollë Minit.

T'u them të drejtën, pak sa u habita, sepse pas një heshtjeje të gjatë, doli një gazetë fetare që askush nuk e kish pritur për shumë arsye.

Kjo gazetë theu një heshtje të madhe, e cila pos elementit fetar, kishte edhe e atë kombëtar.

Prania e një gazete të tillë përbante esencën, ku konstrukt i saj ishte përplot shpjegime të një kategorie tekstesh që më shumë flitej për fenë katolike, si element kulturë në kohën kur regjimi i atëhershëm luftonte kundër „territ fetar“, siç e prediknin këndej dhe andej kufirit mbarë shqiptar.

Pra, kjo më habiti për dy arsye. E para dhe më kryesorja, për faktin se sa mund i është dashtë botuesve që ta marrin lejen për botimin e një gazete të tillë, dhe e dyta guximi i fjalës së shkruar, kur Kisha dhe priftërinjtë ishin në mbikëqyrje të vazhdueshme të shtetit. Është vështirë të përkufizohen këto dy gjëra, kur kemi parasysh sintagmën e territ nga të dy anët, pra të shtetit ku fetë i merrnin si „terri i civilizimit“ nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, botuesit e kësaj gazete, të cilët bënin betejën e vazhdueshme me terrin në nënqrellin arbëror, siç edhe thuhet në editorialin e kësaj gazete „Lufta kundër territ, që shkruhet në logon e saj si politikë redaktuese e revistës, u bë (do të jetë edhe tani) parim jete për fjalëpërcuesit, dijedhësit e formuesit që kontribuonin në faqet e saj.“

Nuk do të përqendrohemi në tekstet e shkruara në atë kohë, sepse, dihet, ato kanë luajtur rolin e tyre edukues dhe fetar, dhe as krajtat e përjetuara të klerit, edhe pse i vogël, më kujtohen, sa maltretime kanë përjetuar priftërinjtë shqiptar katolikë sidomos Don Rroku e më vonë dhe Monsinjori Don Nikollë Mini dhe të tjerët, në mbledhjet e Frontit socialist të kritikuar edhe nga ca aktivistë të Frontit, si quhej atëherë, të fesë katolike, të cilët i kishin detyruar që të flasin kundër

klerit të tyre shqiptar, kurse ata më aktivë ishin vullnetarë të së keqes dhe prinin në kritikën dhe sharje ndaj klerit katolik. Sa përbuzje ka përjetuar vetë Monsinjori Nikollë Mini nga gazetarët e gazetave të pakta që botoheshin në Kosovë. Le të na kujtohen polemikat të argumentuara nga Monsinjori me jo njein, por me disa gazetarë të Rilindjes, e ndër ta printe Jusuf Ferizi, edhe pse ajo kishte dhe botonte artikuj me parime të shëndosha, dhe kështu luajti rol të madh duke luftuar fanatizmin, injorancën me injorantët e paskrupullt. Na duhen faqe të tëra që të përshkruajmë krajtat e tyre, por ne kësaj here do të përqendrohemi në materialin e botuar në numrin e saj të parë.

Shkrimet në këtë gazetë (Drita 1 2007) janë studime të mirëfillta të shkruara me një gjuhë bashkëkohore dhe nuk hasim në asnjë vend në fjalët e vjetruara dhe dialektore siç kemi pasur rastin të shohim në ca botime fetare. Në këto shkrime kemi informata aktuale, por hasim edhe në mendime filozofike që paraqesin kthesë në të shtruarit e problemeve dhe në të menduarit dhe trajtimin e tyre, duke artikuluar pikëvështrime të qasjeve moderne të fesë, por edhe pa e harruar çështjen kombëtare dhe vlerat e saj e që Kisha gjithmonë i është përmbytur binomit për Atdhe dhe Fe, e sidomos i jep rëndësi formimit dhe edukimit të krishterë edhe rolin të saj primar që ndodhet në idiomat e ndryshme të popullsisë.

Punimet e Dritës paraqesin një sintezë reprezentative të autorëve në fjalë, por kërkojmë edhe një sqarim, pse i është lënë vetëm dy faqe Kishave në Kosovë. Mendoj se është dashtë më shumë të flitet për famullitë në Kosovë dhe aktivitetin e tyre si dhe propozoj që kjo revistë ta ketë edhe një këndë ku ishin botuar edhe këngët e traditës dhe këngët e reja të kompozuar enkas prej kompozitorëve tanë. (Shkrimi jepet në versionin e shkurtër. Vër. e red.)

Akil Koci, Londër

RIDALJA I GAZETËS DRITA PËR MUA është një satisfaksion shpirtëror dhe ma ka ngjallur shpresën se Kisha Katolike di e do të dijë ta mbajë gjallë bërthamën intelektuale dhe shpirtërore të këtij populli.

Gazetën e kam lexuar me ëndje dhe kënaqësi të veçantë. Tematikat që janë shtjelluar, kanë një vlerë, cilësi, dhe burim informacioni, do të thosha krejt të veçantë, dhe kjo si rezultat i asaj se redaksinë e përbëjnë figura të shquara intelektuale dhe fetare të dëshmuara që moti në letrat shqipe.

Në të ardhmen kisha preferuar që një rubrikë e veçantë t'i takojë fenomenit të emigrimit, posaçërisht të rinjve. Mandej, do të ishte me vlerë një rubrikë me poezi, prozë dhe mjekësi. Do të ishte e arsyeshme që përbrenda gazetës të përfshiheshin të gjitha famullitë e Kosovës, që do t'i paraqitnin njerëz kompetentë, sepse kjo do t'i shërbente dhe kontribuonte edhe unifikimit intelektual dhe fetar të kësaj popullate plot kriza.

Llogaris se kjo redaksi do t'ia arrijë qëllimit, dhe me një punë serioze do të bëhet një gazetë konkurruese brenda dhe jashtë Kosovës. Urimë!

Wilson Culaj, Klinë

PËRGËZIME; FAT E SUKSESE, TË NDERUAR!

U gëzoja që "Drita" sërisht u duk në horizontin shqiptar. Edhe më shumë u gëzoja kur pashë se pishtari ynë ishte në duart e Don Lushit. "Drita" kishte edhe një motiv shtesë; prezantimin e ipeshkvit tonë të nderuar në takim me Atin e Shenjtë.

Duke ju dëshiruar vullnet të mirë, shëndet e sukses, ju përgëzoj!

Bardh Frangu, Ferizaj

I NDERUARI KRYEREDAKTOR,

REDAKTOR, këshilli redaktues dhe gjithë ju që kontribuoni në këtë revistë, ju përsërendes përzemërsisht. Me të vërtetë keni bërë një punë të madhe, sepse e keni ringjallur Dritën. Besoj që kjo „DRITË“ do të jetë Drita e Jezu Krishtit të Ringjallur. Unë më vëmendje e kam lexuar revistën tuaj e më ka pëlqye shumë, sepse kishte tema shumë interesante. Ju lus që të shkruani më shumë për historinë e

Kishës Katolike tek populli Shqiptar, identitetin e shqiptarëve... Zoti Ju ndihmoftë në realizimin e veprave Tuaja.

Besim Ndou, Pjetërshan

Drita agon sërisht

Shumë e nderuara Redaksi

Sa shumë jemi të gëzuar

Drita agoi përsëri

Të lavdëron

Çdo besimtar

Me zemër galdon

Për revistën e dashur

Nder ne vepër

E bardhë që zemrat na pasuron

Dritën zgjuar

Ne e presim

Ajo është dritë e bardhë

E mbyt terrin anëmbanë

E vërteta Dituria

Janë shtylla nga jeta,

E kjo është drita e vërteta

Drita terrin

Kudo e zhbën

Për njeriun

Dashuri reshe

Lum ai dritën

Që e lexon

Ta shfletojë

Pra me kujdes

Drita të çon

Kah qytetërimi

E ardhmëria

Drita është

Edhe historike

Na mëson shumë

Për fe e atdhe

Për kulturë e shkencë

Kolë Çetta, Prizren

DRITA


Të nderuar/a lexues/e!

Kjo faqe është rezervuar për ju, për opinionet, sugjerimet dhe komentet për sa i përket DRITËS, si dhe dukurive të tjera nga jeta jonë shoqërore, kulturore, fetare... etj.


Fjala Juaj do të jetë nderim dhe kontribut për ne. Faleminderit!

Këshilli redaktues i DRITËS

Email për ju: revistadrita@yahoo.com;
revistadrita@hotmail.com



Disa prej revistave tona në Kosovë





Qendra Sociale-Edukative

„Don Bosko” është e themeluar në parimet e sistemit preventiv (parandalues) të Don Boskos. Sistemi parandalues i don Boskos bazohet në katër shtylla:

Shtëpia, ajo e cila mirëpret.

Oborri, ku luhet dhe shoqërohet, krijohen miqësi të reja.

Shkolla, e cila formon, edukon dhe e përgatit për jetë.

Kisha, është ajo e cila ungjillëzon dhe shpall Lajmin e gëzueshëm.

Pa këto katër shtylla nuk mund të edukohet një i ri apo e re në sistemin parandalues. Pa këto nuk ka edukim integral.

Mesazhi edukativ i Don Boskos është: **Arsyë, besim, dashamirësi**. Në bazë të sistemit të tij parandalues gjendet një dashuri e thellë për të rinjtë, çelësi i gjithë veprës edukative. Në edukimin e të rinjve Qendra don Bosko përfshin të riun në tërësi. Don Bosko thoshte që edukimi është diçka që bëhet me zemër dhe që padroni ose pronari

i tij është vetëm Hyji. Ne nuk mund të arrijmë asgjë, në qoftë se Hyji nuk na mëson artin dhe nuk na jep çelësa në dorë.

Qendra Sociale-Edukative „Don Bosko” në Prishtinë është themeluar në vitin 2000, ndërsa gurtthemeli është vënë më 28 nëntor 2001. Në muajin maj të vitit 2002 kanë filluar punët për ndërtimin e Qendrës dhe më 8 tetor të vitit 2003 është bërë hapja e Qendrës nga ish-presidenti tani i ndjeri Dr. Ibrahim Rugova, ish-kyeadminstratori i UNMIK-ut, lpushkvi i Kosovës tani i ndjeri mons. Mark Sopi, Kryetari i Kuvendit Komunal të Prishtinës, Arqipeshkvi i Tivarit mons. Zef Gashi, shumë meshtarë dhe motra te Kosovës dhe jashtë Kosovës, si dhe donatorët nga Gjermania, Italia, Holanda, Spanja dhe nga Provinca jonë prej Napolit.

Kjo Qendër është një ndër më modernet në rajon. Qendra i aftëson dhe i përgatit kuadrot për punësim në fushat e ndryshme siç janë: kurse

të elektroteknikës: civile, industriale, citofoni, elektronikë dhe riparimet e pajisjeve të kompjuterëve, operatorë të zyrave profesionale, kontabilistë, sekretare profesionale. Në tre laboratorë të informatikës zhvillohen këto programe: packet office, exel e acces si dhe atë të avancuar, autocad, menaxhim i financave me programin me të ri Quickbooks - programe amerikane. Po ashtu Qendra organizon edhe kurse të gjuhëve të huaja: gjuhë angleze, gjermane dhe gjuhë italiane; të gjitha këto zhvillohen sipas kërkesave.

Në kuadër të Qendrës është edhe Oratori dhe Qendra Rinore ku zhvillohen aktivitetet kulturore, artistike, teatrale, sportive-kampionate, festivale dhe punë sociale për t'i heqë të rinjtë nga rruga...

Në një të ardhme të shpejt Qendra don Bosko do të ofrojë edhe një shkollë të mesme 4 vjeçare, Liceun Elektroteknik „Don Bosko”,

drejtimin kompjuteristik-informatik. Nga viti i ardhshëm me projektin e Qeverisë së Luxemburgut do të ofrojë këto shërbime: Laboratorin e pajisur për saldime të ndryshme, laboratorin hidraulik, termo-hidraulik dhe nxehjes qendrore, si dhe laboratorin për përpunimin e frutave dhe perimeve.

Don Bosko posedon fusha sportive, të futbollit dhe të basketbollit, salla të mëdha për konferenca, seminare dhe për takime rinore.

Mirë se vini në Qendrën tonë!

Adresa jonë:

**Rr. Tahir Zajmi, p.n
10000 Prishtinë-Kosovë
Tel: 038 - 541 - 169**

Fax: 038 - 541 - 170

Website: www.donbosko-ks.com
E-mail: donbosko@yahoo.it